



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2023 – Numri: 69

Tiranë – E premte, 28 prill 2023

PËRMBAJTJA

	Faqe
Akt normativ i Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 27.4.2023	Për një shtesë në ligjin nr. 8952, datë 10.10.2002, “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, të ndryshuar..... 8171
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 254, datë 20.4.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 548, datë 27.7.2016, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e kritereve, të rregullave e procedurave për përfitimin e pensioneve shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar..... 8171
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 260, datë 27.4.2023	Për miratimin e projekteve fituese të financuara nga fondi për parandalimin dhe menaxhimin e fatkeqësive natyrore, si dhe të autoritetit kontraktor për zbatimin e projekteve, sipas njërive të vetëqeverisjes vendore..... 8172
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 27.4.2023	Për pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në stërvitjen “ <i>Defender Europe 2023</i> ” jashtë vendit..... 8173
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 262, datë 27.4.2023	Për disa ndryshime në vendimin nr. 531, datë 29.7.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e numrit të përgjithshëm të personelit të Policisë së Shtetit dhe përcaktimin e funksioneve korresponduese e kategorizimin për gradat në policinë e shtetit”..... 8173
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 263, datë 27.4.2023	Për disa ndryshime në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për zbatimin nga Republika e Shqipërisë të vendimeve të Këshillit të Bashkimit Evropian, për vendosjen, ndryshimin dhe shfuqizimin e masave shtrenguese ndërkombëtare, të ndryshuara”, të ndryshuar..... 8178
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 264, datë 27.4.2023	Për miratimin e procedurave, kritereve dhe rregullave për zbatimin e programit të nxitjes së punësimit, sipas skemës së garancisë rinore nëpërmjet të nxënit në vendin e punës 8186

Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 265, datë 27.4.2023	Për disa ndryshime në vendimin nr. 1039, datë 4.12.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për funksionimin e Këshillit Kombëtar të Punës dhe për caktimin e përfaqësuesve të Këshillit të Ministrave në këtë këshill”, të ndryshuar.....	8190
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 267, datë 27.4.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 559, datë 29.7.2022, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënien në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike dhe për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore”.....	8191
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 268, datë 27.4.2023	Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr. 247, datë 30.4.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e rregullave, të kërkesave e të procedurave për informimin dhe përfshirjen e publikut në vendimmarrjen mjedisore”.....	8192
Vendim i Gjykatës Kushtetuese nr. 13, datë 21.3.2023	Me objekt shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-1082 (189), datë 13.5.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.....	8193
Vendim i Këshillit të Lartë të Prokurorisë nr. 70, datë 30.3.2023	Për miratimin e rregullores “Për përcaktimin e rregullave dhe arsyeve të lejimit të kandidatit për magistrat për t’u emëruar në vitin pasardhës”.....	8202
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 347, datë 13.4.2023	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të “Partisë Socialiste të Shqipërisë”, qarku Elbasan, z. Shkëlqim Shefqet Bullari.....	8204
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 348, datë 13.4.2023	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të koalicionit “Partia Demokratike–Aleanca për Ndryshim”, qarku Tiranë, z. Asllan Shaban Dogjani.....	8206
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 349, datë 13.4.2023	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të koalicionit “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim”, qarku Shkodër, z. Lodovik Stak Hasani....	8207
Vendim i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr. 350, datë 13.4.2023	Për dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Shqipërisë, kandidatit të listës shumemërore të koalicionit “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim”, Partia Republikane Shqiptare (PR) (qarku Elbasan, z. Qani Rexhep Xhafa.....	8209
Kërkesë e Agjencisë Shtetërore për Shpronësimet nr. 220/9, datë 25.4.2023	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Projekt i parkut ujqor Tushemisht–Drilon”.....	8211

**AKT NORMATIV**
Nr. 1, datë 27.4.2023**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN
NR. 8952, DATË 10.10.2002, “PËR
LETËRNJOFTIMIN ELEKTRONIK
TË SHETASVE SHQIPTARË”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:**Neni 1**

Pas nenit 9/3, të ligjit nr. 8952, datë 10.10.2002, “Për letërnjoftimin elektronik të shtetasve shqiptarë”, të ndryshuar, shtohet neni 9/4, me këtë përmbajtje:

“Neni 9/4

Dispozitë kalimtare

Afati i vlefshmërisë së letërnjoftimit elektronik të shtetasve, votues në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore, të shpallura me dekretin nr. 13864, datë 24.10.2022, të Presidentit të Republikës, që përfundon deri në datën 14 maj 2023, zgjatet deri në datën 31 maj 2023.”.

Neni 2**Hyrja në fuqi**

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 254, datë 20.4.2023**PËR DISA SHITESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 548, DATË 27.7.2016,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E KRITEREVE, TË
RREGULLAVE E PROCEDURAVE PËR
PËRFITIMIN E PENSIONEVE
SHTETËRORE SUPLEMENTARE TË
PERSONAVE QË KRYEJNË FUNKSIONE
KUSHTETUESE DHE TË PUNONJËSVE
TË SHTETIT”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1, 15 e 17, të ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për pensionet shtetërore suplementare të personave që kryejnë funksione kushtetuese dhe të punonjësve të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 548, datë 27.7.2016, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në lidhjen nr. 1, bashkëlidhur vendimit, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

a) Në ndarjen e dytë “Institucione të tjera të pavarura, të krijuara me ligj”, shtohet emërtesa “Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit”;

b) Në ndarjen e tretë “Institucione në varësi të Kryeministrit”, shtohet emërtesa “Agjencia Shtetërore e Programimit Strategjik dhe Koordinimit të Ndihmës” dhe emërtesa “Komiteti Shtetëror i Minoriteteve” ndryshohet me “Komiteti për Pakicat Kombëtare”.

2. Në lidhjen nr. 2, bashkëlidhur vendimit, bëhen këto shtesa:

a) Në ndarjen “Për grupin e dytë”, të shkronjës “c”, të pikës 9, të nenit 1, të këtij ligji”, shtohen funksionet:

i. “Specialist i Bërthamës Komanduese Elektronike/hetues financiar/ekspertë në Strukturën e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar”;

ii. “Ndihmës - inspektor në Inspektoratin e Lartë të Drejtësisë”.



3. Shkronja “ç”, e pikës 11, të këtij vendimi, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Funksioni/pozicioni “Kryetar i këshillit të rrethit” dhe “Kryetar i Komitetit Ekzekutiv Pluralist”, zëvendësohet me “Kryetarit të bashkisë”, si dhe pozicioni “Sekretar i Përgjithshëm në këshillin e rrethit” zëvendësohet me “Sekretar i Përgjithshëm në bashki”.

4. Ngarkohet Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 260, datë 27.4.2023

**PËR MIRATIMIN E PROJEKTEVE
FITUESE TË FINANCUARA NGA FONDI
PËR PARANDALIMIN DHE
MENAXHIMIN E FATKEQËSIVE
NATYRORE, SI DHE TË AUTORITETIT
KONTRAKTOR PËR ZBATIMIN E
PROJEKTEVE, SIPAS NJËSIVE TË
VETËQEVERISJES VENDORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 15, e të pikës 9, të aneksit 6, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, me

propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së projekteve fituese të financuara nga Fondi për Parandalimin dhe Menaxhimin e Fatkeqësive Natyrore, si edhe të autoritetit kontraktor për zbatimin e projekteve, sipas njësive të vetëqeverisjes vendore, sipas shtojcës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Mbrojtjes, Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

SHTOJCA 1

PROJEKTET FITUESE TË FINANCUARA NGA FONDI PËR PARANDALIMIN DHE MENAXHIMIN E FATKEQËSIVE NATYRORE						
Nr.	Bashkia	Titulli i projektit	Vlera e projektit (lekë)	Afati i kryerjes së punimeve	Vlera e financimit për 2023	Autoritet kontraktor
1	Maliq	Zhblokim i shkarkuesve dhe kanal ujëmbledhës	57,133,168.00	9 muaj	39,011,511.89	Bashkia Maliq
2	Përrenjas	Rikonstruksion i kanalit kryesor përroi i Lingajcës nga rruga e fushës deri tek lagja e Hallidrit, fshati Rrajcë, NJA Rrajcë	10,000,316.00	3 muaj	10,000,316.00	Bashkia Përrenjas
3	Pustec	Sistemimi i shtatit të përroit në Gorricë e Madhe për mbrojtjen e fshatit nga përmbytja	53,016,515.00	5 muaj	53,016,515.00	Bashkia Pustec
4	Krujë	Punime për rehabilitimin e shkarkuesit, rezervuari Vrijon dhe sistemim i përroit lagja nr. 3, Kovaçe, Krujë	16,785,902.00	5 muaj	16,785,902.00	Bashkia Krujë
5	Korçë	Rehabilitim dhe veshje me beton, Kanali Drenovë, Ndërtim tombino BOX 2X (5x3 m), fshati Gurmuja dhe rikonstruksion i rrugës auto pyjore Denas	11,486,731.00	3 muaj	11,486,731.00	Bashkia Korçë
6	Shkodër	Reduktimi i pasojave të përmbytjes e zonën e nën Shkodrës	19,704,757.00	6 muaj	16,420,630.83	Bashkia Shkodër
7	Mirditë	Mbrojtje nga përroi Jezull në fshatin Jezull, Rrëshen	16,260,167.00	6 muaj	13,550,139.17	Bashkia Mirditë
8	Has	Rehabilitim, përforsim, tri Ura Rruga Ngjic-Pec, NJA Golaj dhe rehabilitim i kuletës dhe bazamentit i kanalit të betonit, përroi Tërshenes	6,747,428.00	1.5 muaj	6,747,428.00	Bashkia Has
9	Mat	Rikonstruksion ure pasarel në fshatin Rreth-Bazë, NJA Bazë, Bashkia Mat	18,378,809.00	5 muaj	18,378,809.00	Bashkia Mat
10	Fushë-Arrëz	Rindërtimi i mureve mbajtës të shesheve të pallateve në qytetin Fushë-Arrëz	34,212,228.00	3 muaj	34,212,228.00	Bashkia Fushë-Arrëz
11	Përmet	Rehabilitimi i digës së urës së Pcemit	47,786,400.00	8 muaj	37,137,363.00	Bashkia Përmet
12	Devoll	Mbrojtje nga ujerat e larta dhe sistemimi i përroit të SMT-së	52,305,857.00	8 muaj	32,691,160.63	Bashkia Devoll
13	Kolonjë	Rezervuar i Gjonçit, prita malore në fshatrat Mësiçkë, Taç Poshtë	24,311,795.00	4 muaj	24,311,795.00	Bashkia Kolonjë
14	Gramsh	Ndërtim i urës tip bailey, përroi i Çumes (Dushit), në rrugën automobilistike Kurad-Grabova NJA Lenie	12,742,026.00	3 muaj	12,742,026.00	Bashkia Gramsh
15	Poličan	Mbrojtje lumore gjatësore nga lumi Osum, fshati Mbrakull, Poličan	70,866,157.00	4 muaj	70,866,157.00	Bashkia Poličan



16	Kukës	Rehabilitim i urave në fshatrat gëshenjë, Orgjost	10,624,287.30	0.5 muaj	10,624,287.30	Bashkia Kukës
17	Pogradec	Sistemim i lumit të Buçimasit dhe rehabilitim i infrastrukturës rrugore përgjatë tij, loti I	95,138,452.00	12 muaj	46,911,884.67	Bashkia Pogradec
18	Tropojë	Ndërtim ura të reja, rikonstruksion ura e veptra ujitëse	20,719,207.00	5 muaj	20,719,207.00	Bashkia Tropojë
19	Durrës	Përforcim terreni nga rrëshqitja në zonën e NJA-ve nr. 2, nr. 4, Ishëm	7,987,124.29	2.5 muaj	7,987,124.29	Bashkia Durrës
20	Malësi e Madhe	Ura lidhëse për fshatrat Vermosh–Velan–Velipojë	68,238,646.30	9 muaj	45,181,222.06	Bashkia Malësi e Madhe
21	Elbasan	Ndërtimi i rrjetit të hidrantëve për Krastën	10,898,428.00	5 muaj	10,898,428.00	Bashkia Elbasan
22	Pukë	Ura auto në fshatin Plan	5,385,401.00	1.5 muaj	5,385,401.00	Bashkia Pukë
23	Selenicë	Trajtim rrëshqitje rruge në fshatin Peshkëpi.	11,951,343.18	2 muaj	11,951,343.18	Bashkia Selenicë
24	Tiranë	Rehabilitim emergjent i përroit të Gjerezës te Fresku L=620 m	86,055,640.00	6 muaj	71,713,033.33	Bashkia Tiranë
25	Kuçovë	Mbrojtje nga gërryerja e rrugës kryesore në përroit e Lumasit, krahu i majtë pranë urës së Lumasit, ndërtimi i tri urave në përroit e Saraselasit, Belesovës dhe Mendrakes, si dhe ndërtimi i rrugës lidhëse	67,469,951.70	9 muaj	37,483,306.50	Bashkia Kuçovë
26	Dropull	Mbrojtja nga përroi i Selosë, Dropull, faza I	38,365,328.76	5 muaj	38,365,328.76	Bashkia Dropull
27	Dimal	Mbrojtje lumore në fshatin Arrëz, Bashkia Dimal	63,951,970.00	8 muaj	39,969,981.25	Bashkia Dimal
28	Roskovec	Ndërrhyrje për sigurinë e rezervuarit të Ngjeqarit	94,827,604.00	12 muaj	46,782,364.67	Bashkia Roskovec
29	Gjirokastrë	Masa inxhinierike për stabilizimin e rrëshqitjes së masës në kodrën e Cfaqës, pranë rrugës nacionale Gjirokastrë–Kakavijë, loti 2	48,281,143.00	7 muaj	34,486,530.71	Bashkia Gjirokastrë
30	Klos	Ndërtim Urë Beton Arme 4*17 m mbi lumin Mat, në fshatin Dom, NJA Gurrë, Klos	99,845,397.00	12 muaj	48,873,111.75	Bashkia Klos
Vlera e financimit të projekteve fituese për vitin 2023					874,691,266.98	

VENDIM
Nr. 261, datë 27.4.2023

PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË NË STËRVITJEN
“DEFENDER EUROPE 2023”
JASHTË VENDIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “b”, të pikës 2, të nenit 8, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për dërgimin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë jashtë vendit dhe për mënyrën e procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pjesëmarrjen e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në stërvitjen “*Defender Europe 2023*” jashtë vendit, sipas nivelit dhe rajoneve, si më poshtë vijon:

a) 127 (njëqind e njëzet e shtatë) efektivë këmbësorie dislokohen në Maqedoninë e Veriut, nga data 21 maj 2023 deri më 3 qershor 2023;

b) 30 (tridhjetë) efektivë këmbësorie dislokohen në Kosovë, nga data 21 maj deri më 3 qershor 2023;

c) 30 (tridhjetë) efektivë të Policisë Ushtarake dislokohen në Kroaci, nga data 15 maj deri më 4 qershor 2023;

ç) 4 (katër) efektivë të Forcave të Armatosura dislokohen në Kroaci, nga data 15 maj deri më 4 qershor 2023;

d) 14 (katërbëdhjetë) efektivë këmbësorie dislokohen në Slloveni, nga data 21 maj 2023 deri më 3 qershor 2023;

dh) 30 (tridhjetë) efektivë të Policisë Ushtarake dislokohen në Rumani, nga data 27 maj 2023 deri më 7 qershor 2023.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

3. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 262, datë 27.4.2023

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN
NR. 531, DATË 29.7.2022, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E
NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË
PERSONELIT TË POLICISË SË SHETITIT
DHE PËRCAKTIMIN E FUNKSIONEVE
KORRESPONDUESE E KATEGORIZIMIN
PËR GRADAT NË POLICINË
E SHETITIT”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19, pika 6, e 61, pika 1, të ligjit nr. 108/2014, “Për Policinë e Shtetit”, të ndryshuar,



me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 531, datë 29.7.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në pikën 1, togfjalëshi “ ... 11 834 (njëmbëdhjetë mijë e tetëqind e tridhjetë e katër) ...” zëvendësohet me “... 11 932 (njëmbëdhjetë mijë e nëntëqind e tridhjetë e dy) ...”.

2. Lidhja nr. 1, e përmendur në pikën 2, “Tabela e funksioneve korresponduese dhe kategorizimi për çdo gradë”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe titull, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

II. Ngarkohet Ministria e Brendshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Belinda Balluku

Lidhja 1

TABELA E FUNKSIONEVE KORRESPONDUESE PËR ÇDO GRADË DHE KATEGORIZIMI I TYRE

GRADAT	NUMRI LIMIT PËR GRADË	FUNKSIONET
Drejtues madhor	1	Drejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit.
Drejtues i lartë Drejtues i lartë	8	Zëvendësdrejtor i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit, Drejtorët e Departamenteve dhe Rektori i Akademisë së Sigurisë.
Drejtues i parë	56	<p>A. Në strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit</p> <ol style="list-style-type: none"> Drejtor, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit; Drejtor, në Departamentet e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit. Drejtor i kabinetit të drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit (Zyra Ndihmëse); Këshilltar në kabinetin e drejtorit të përgjithshëm të Policisë së Shtetit (Zyra Ndihmëse); <p>B. Në strukturat e veçanta</p> <ol style="list-style-type: none"> Drejtor, në Drejtorinë e Antiterrorit, në Institutin e Policisë Shkencore, në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale, në Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë dhe funksione të barasvlershme me to. <p>C. Në Akademinë e Sigurisë</p> <ol style="list-style-type: none"> Drejtor/Dekan; Drejtor i Qendrës së Kërkimeve Shkencore dhe Projekteve; Përgjegjës Departamenti, në Fakultet; Pedagog; Drejtor i Kolegjit Profesional të Formimit Policor; Drejtor i Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë. <p>D. Në strukturat e Drejtorive Vendore të Policisë</p> <ol style="list-style-type: none"> Drejtor i Drejtorive Vendore të Policisë.
Drejtues	141	<p>A. Në strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit</p> <ol style="list-style-type: none"> Shef sektori, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Departamentet në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit; Asistent i zëvendësdrejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit; Asistent i drejtorit të Departamentit në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit; Oficer kontakti ndërlidhës, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe funksione të barasvlershme me to. <p>B. Në strukturat e veçanta</p> <ol style="list-style-type: none"> Komandant i Njësisë Speciale “RENEA”; Drejtor i Qendrës së Mbyllur të të Huajve të Kufirit dhe Migracionit; Shef Sektori, në Drejtorinë e Antiterrorit, në Institutin e Policisë Shkencore, në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale, në Drejtorinë e



		<p>Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë dhe funksione të barasvlershme me to.</p> <p>C. Në Akademinë e Sigurisë</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Asistent Rektori në Akademinë e Sigurisë; 2. Lektorë në Fakultet; 3. Shef i Qendrës të Trajnimeve Taktike Operacionale; 4. Përgjegjës Departamenti/Instruktur në Kolegjin Profesional të Formimit Policor dhe funksione të barasvlershme me to. <p>D. Në drejtoritë vendore të policisë</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Drejtor i drejtorive vendore, të policisë kufitare dhe migracionit; 2. Zëvendësdrejtor, në drejtoritë vendore të Policisë.
Kryekomisar	449	<p>A. Në strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Specialist në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe në Departamentet në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit; 2. Shef Njësie; 3. Oficer kontakti ndërlidhës, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe funksione të barasvlershme me to. 4. Shef Qendre/Koordinator institucional në Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare. <p>B. Në strukturat e veçanta .</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Shef Njësie të Ndërhyrjes së Shpejtë; 2. Shef i Institutit të Përgatitjes së Qenve të Policisë; 3. Shef sektori në Njësinë Speciale “RENEA”; 4. Shef i Njësisë Speciale, për Kufirin dhe Migracionin “DELTA”; 5. Shef i Njësisë Speciale të Mbrojtjes së Veçantë, “NJSMV” 6. Shef Sektori në Njësinë “FAST Albania”; 7. Shef njësie/specialist në Njësinë Speciale të Antieksplzivëve dhe në Njësinë Speciale të Negocimit; 8. Shef i Njësisë së Sigurisë dhe Ceremonialit; 9. Specialist koordinator me SHISH, specialist drejtimi, specialist në sektorin e analizës dhe kartotekës, shef i njësie rajonale antiterrorizëm, shef i njësisë për hetimin e financimit të terrorizmit, shef i njësisë për verifikimin e terrorizmit dhe sigurisë dhe shef i njësisë operacionale antiterrorizëm, në Drejtorinë e Antiterrorit; 10. Shef sektori për përgjimin e telekomunikimit në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale; 11. Specialist në Drejtorinë e Antiterrorit, në Institutin e Policisë Shkencore, në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale, në Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë dhe funksione të barasvlershme me to. <p>C. Në Akademinë e Sigurisë</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Shef Sektori i Burimeve Njerëzore; 2. Shef Sektori/instruktur në Qendrën e Trajnimeve Taktike Operacionale; 3. Lektor/Kërkues i Parë në Qendrën e kërkimeve Shkencore dhe Projekteve; 4. Asistent/Lektorë në Fakultet; 5. Specialist për Marrëdhëniet me Jashtë dhe Cepol; 6. Shef sektori/instruktur; specialist për Kurrikulat/Instruktur në Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë; 7. Shef Sektori në Qendrën e Edukimit Fizik dhe Sporteve Elitare; 8. Përgjegjës Departamenti/Instruktur në Kolegjin Profesional të Formimit Policor dhe funksione të barasvlershme me to. <p>D. Në strukturat e Drejtorive vendore të Policisë</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Shef sektori në drejtoritë vendore të policisë dhe drejtoritë vendore të kufirit e migracionit; 2. Asistent, në drejtoritë vendore të policisë; 3. Shef Komisariati, në drejtoritë vendore të policisë dhe në ato të kufirit dhe migracionit me personel mbi 45 punonjës dhe funksione të barasvlershme me to.



Komisar	636	<p>A. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Specialist në Departamentin e Policisë Kriminale; 2. Oficer kontakti ndërlidhës, në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe funksione të barasvlershme me to. <p>B. Në strukturat e veçanta</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Specialist në sektorin për përgjimin e telekomunikimin në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale; 2. Shef seksioni, në njësitë speciale dhe në njësitë e ndërhyrjes së shpejtë; 3. Specialist koordinator ai zëvendëskomandant, specialist i trajnimeve dhe masave mbrojtëse, shef i Njësisë Operacionale në Repartin Special “RESI”; 4. Shef i Qendrës së Drejtimit dhe Menaxhimit të Operacioneve Speciale, shef njësie/specialist në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale; 5. Shef njësie operacionale, shef seksioni, në Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë; 6. Shef njësie në sektorët e Drejtorisë së Forcës së Posaçme Operacionale; 7. Shef Seksioni në Repartin e Sigurisë së Brendshme e Ceremonialit, në Institutin e Përgatitjes së Qenve të Policisë dhe në Qendrën e Mbyllur të të Huajve të Kufirit dhe Migracionit; 8. Specialist në njësinë operacionale antiterrorizëm, specialist në njësinë rajonale antiterrorizëm, specialist në njësinë për hetimin e financimit të terrorizmit dhe specialist në njësinë për verifikimin e terrorizmit dhe sigurisë, në Drejtorinë e Antiterrorit dhe funksione të barasvlershme me to. <p>C. Në Akademinë e Sigurisë</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Specialist/instruktor, në Qendrën e Trajnimeve Taktike Operacionale; 2. Specialist/instruktor, në Kolegjin Profesional të Formimit Policor; 3. Specialist për planifikimin dhe koordinimin/Instruktor; Specialist për kontrollin dhe shërbimin studentor/Instruktor; Specialist për sigurimin e cilësisë/Instruktor, në Drejtorinë e Kurrikulave dhe Sigurimit të Cilësisë; 4. Shef Seksioni në Qendrën e Edukimit Fizik dhe Sporteve Elitare; 5. Shef Seksioni në Seksionin e Sigurisë; 6. Shef Seksioni/instruktor në Seksionin e Mbikëqyrjes dhe Disiplinës dhe funksione të barasvlershme me to. <p>D. Në drejtoritë vendore të policisë</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Shef komisarati në drejtoritë vendore të policisë dhe në ato të Kufirit dhe Migracionit me personel deri në 45 punonjës. 2. Shef seksioni në drejtoritë vendore të policisë dhe ato të Kufirit dhe Migracionit; 3. Shef seksioni në Komisaritet e Policisë, në drejtoritë vendore të policisë dhe ato të kufirit dhe migracionit; 4. Shef seksioni/specialist në Sektorin e Komandës dhe Kontrollit në drejtoritë vendore të policisë; 5. Shef Stacioni në Komisaritet e Policisë në drejtoritë vendore të policisë dhe në strukturat e kufirit dhe migracionit dhe funksione të barasvlershme me to.
Nënkomisar	1544	<p>A. Në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Specialist në Departamentin e Policisë Kriminale; 2. Oficerë të turnit, Specialist në Qendrën Ndërinstitucionale Operacionale Detare (QNOD), në Departamentin për Kufirin dhe Migracionin. 3. Specialist për RMIS, në Drejtorinë e Burimeve Njerëzore; <p>B. Në strukturat e veçanta.</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Zëvendës shef seksioni/specialist, Specialist në njësitë speciale dhe në njësitë e ndërhyrjes së shpejtë; 2. Zëvendës shef njësie, në Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë; 3. Specialist dhe funksione të barasvlershme me to. <p>C. Në Akademinë e Sigurisë</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Specialist për disiplinën në Fakultet, specialist për disiplinën në Kolegj/Instruktor në Sektorin e Disiplinës dhe Sigurisë; 2. Specialist për trajnimet në Sektorin e Burimeve Njerëzore; 3. Instruktor në Qendrën e Edukimit Fizik dhe Sporteve Elitare; 4. Përgjegjës turni dhe Informacioni dhe funksione të barasvlershme me to.



		<p>D. Në drejtoritë vendore të policisë</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Specialist në drejtoritë vendore të policisë dhe specialist në drejtoritë vendore kufirit dhe migracionit; 2. Specialist në komisaritet e policisë; 3. Specialist në komisaritet e kufirit dhe migracionit; 4. Shef Poste Policie; 5. Specialist në stacionet e Policisë; 6. Specialist në Seksionet dhe Stacionet e Policisë Kufitare; 7. Specialist për shërbimet e rendit, ai dhe ekspert Antieksplozivi; 8. Përgjegjës turni, në seksionet dhe Stacionet e Policisë Kufitare dhe funksione të barasvlershme me to.
<p>Inspektor i parë Inspektor i dytë Inspektor</p>	<p>7847</p>	<ol style="list-style-type: none"> 1. Përgjegjës grupi në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale; 2. Ndihmësspecialist në Sektorin për Përgjimet e Telekomunikimit; 3. Ndihmësspecialist për magazinimin e drogave, në Sektorin e Hetimit Nën Mbulim; 4. Ndihmësspecialist në Sektorin e Hetimit nën Mbulim; 5. Ndihmësspecialist në DPPSH; 6. Ndihmësspecialist në Drejtorinë e Antiterrorit; 7. Ndihmësspecialist i policimit në komunitet/SPZ; 8. Ndihmësspecialist i policimit në komunitet për edukimin në shkolla dhe punën me të rinjtë/SPZ; 9. Ndihmësspecialist, për zbatimin e vendimeve, kontrollin e armëve; 10. Ndihmësspecialist në sektorin e komandës dhe kontrollit, 11. Ndihmësspecialist/agentë; 12. Ndihmësspecialist, operator për shërbimin ndaj të tretëve, 13. Ndihmësspecialist, laborant; 14. Ndihmësspecialist për informacionin; 15. Ndihmësspecialist në drejtoritë vendore të policisë dhe funksione të barasvlershme me to; 16. Ndihmësspecialist informacioni; 17. Ndihmësspecialist; 18. Kontrollor; 19. Ndihmësspecialist i vijës së dytë dhe kontrollor; 20. Përgjegjës grupi dhe ndihmësspecialist në drejtoritë vendore për 21. Kufirin dhe Migracionin, si dhe funksione të barasvlershme me to. 21. Ndihmësspecialist për analizën/kartotekën/statistikën. 22. Ndihmësspecialist në Seksionin e Verifikimit të Shkeljeve administrative dhe analizës, për shërbimin e Policisë Rrugore. 23. Oficer i patrullës së Përgjithshme (F.P.) Shqiptonja/Motorist dhe funksione organike të barasvlershme me to. 24. Trupë shërbimi operacional në Njësinë Speciale “RENEA” dhe funksione të barasvlershme me to; 25. Ndihmësspecialist, forcë speciale dhe shofer në Njësinë Speciale të Negocimit; 26. Ndihmësspecialist, forcë speciale shoqërues qeni dhe shofer në Njësinë Speciale të Antieksplozivëve; 27. Ndihmësspecialist, forcë speciale në Njësinë Speciale “Resi”; 28. Ndihmësspecialist, forcë speciale në Njësinë Speciale për K-Migracionin “Delta”; 29. Ndihmësspecialist/përgjegjës grupi në njësitë e ndërhyrjes së shpejtë; 30. Ndihmësspecialist në Policinë Shkencore; 31. Ndihmësspecialist në Drejtorinë e Forcës së Posaçme Operacionale; 32. Ndihmësspecialist, forcë speciale në Drejtorinë e Mbrojtjes së Dëshmitarëve dhe Bashkëpunëtorëve të Drejtësisë; 33. Trupë shërbimi operacional në njësitë e ndërhyrjes së shpejtë; 34. Komandant skuadre/trupë shërbimi në Njësinë e Ceremonialit; 35. Ndihmësspecialist për migracionin e parregullt; 36. Ndihmësspecialist, intervistimin, riintegrimin, ripranimin/ kontrollor; 37. Ndihmësspecialist (QSHI me shtetet fqinjë); 38. Drejtues mjeti lundrues; 39. Ndihmësspecialist, kontrollor për mjetet e peshkimit; 40. Ndihmësspecialist për përgatitjen; 41. Ndihmësspecialist, operator për kamerat në stacionet e policisë për Kufirin dhe Migracionin;



		<p>42. Ndhmësspecialist, operator për kamerat në Qendrën e Mbyllur për të Huajt;</p> <p>43. Ndhmësspecialist;</p> <p>44. Zëdhënës;</p> <p>45. Ndhmësspecialist operator;</p> <p>46. Ndhmësspecialist për analizën/kartotekën/statistikën;</p> <p>47. Ndhmësspecialist për krimet dhe policisë shkencore;</p> <p>48. Ndhmësspecialist në seksionin e teknologjisë dhe përgjimit;</p> <p>49. Oficer i Patrullës së Përgjithshme;</p> <p>50. Trupë shërbimi në policinë rrugore;</p> <p>51. Ndhmësspecialist në Komisarariatet e Policisë;</p> <p>52. Oficer i patrullës së Përgjithshme (F.P.) Shqiponja/motorist dhe funksione të barasvlershme me to.</p> <p>53. Ndhmësspecialist sekretari arkiv;</p> <p>54. Ndhmësspecialist në të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit;</p> <p>55. Oficer i Patrullës së Përgjithshme, trupë shërbimi në të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit;</p> <p>56. Trupë shërbimi në të gjitha strukturat e Policisë së Shtetit dhe funksione të barasvlershme me to.</p>
--	--	--

VENDIM

Nr. 263, datë 27.4.2023

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1128, DATË 30.12.2020, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR ZBATIMIN NGA REPUBLIKA E SHQIPËRISË TË VENDIMEVE TË KËSHILLIT TË BASHKIMIT EVROPIAN, PËR VENDOSJEN, NDRYSHIMIN DHE SHFUQIZIMIN E MASAVE SHTRËNGUESE NDËRKOMBËTARE, TË NDRYSHUARA”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 3, pika 3, shkronja “c”, e 6, pikat 2 dhe 5, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe të nenit 5, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit për Evropën dhe Punët e Jashtme dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1128, datë 30.12.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

1. Në pikën 16, të kreut I, fjalët “... (CFSP) 2022/1241 ...” zëvendësohen me “... (CFSP) 2023/422 ...”.

2. Në aneksin 16, bashkëlidhur vendimit, vendimi (CFSP) 2022/1241 zëvendësohet me vendimin (CFSP) 2023/422, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

II. Ngarkohen organet e parashikuara në pikën 1, të nenit 11, të ligjit nr. 72/2019, “Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, dhe në pikën 1, të nenit 7, të ligjit nr. 157/2013, “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, të ndryshuar, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



VENDIM I KËSHILLIT (CFSP) 2023/422 i datës 24 shkurt 2023 për përditësimin e listës së personave, grupeve dhe entiteteve që i nënshtrohen neneve 2, 3 dhe 4 të pozicionit të përbashkët 2001/931/CFSP mbi zbatimin e masave specifike për të luftuar terrorizmin dhe shfuqizimin (CFSP) 2022/1241

KËSHILLI I BASHKIMIT EVROPIAN,

Duke pasur parasysh Traktatin për Bashkimin Evropian, dhe në veçanti nenin 29 të tij,

Duke pasur parasysh propozimin e Përfaqësuesit të Lartë të Bashkimit për Punë të Jashtme dhe Politikë të Sigurisë,

Ndërkaq:

- (1) Më 27 dhjetor 2001, Këshilli miratoi qëndrimin e përbashkët 2001/931/CFSP ⁽¹⁾.
- (2) Më 18 korrik 2022, Këshilli miratoi Vendimin (CFSP) 2022/1241 ⁽²⁾, përditësimi i listës së personave, grupeve dhe subjekteve që i nënshtrohen neneve 2, 3 dhe 4 të Pozicionit të Përbashkët 2001/931/CFSP ('lista').
- (3) Në përputhje me nenin 1(6) të pozicionit të përbashkët 2001/931/CFSP, është e nevojshme të rishikohen në intervale të rregullta emrat e personave, grupeve dhe subjekteve në listë për të siguruar që ka arsye për mbajtjen e tyre në të..
- (4) Ky Vendim përcakton rezultatin e rishikimit që Këshilli ka kryer në lidhje me personat, grupet dhe entitetet për të cilat zbatohen nenet 2, 3 dhe 4 të pozicionit të përbashkët 2001/931/CFSP.
- (5) Këshilli ka verifikuar që autoritetet kompetente, siç përmendet në nenin 1(4) të pozicionit të përbashkët 2001/931/CFSP, kanë marrë vendime në lidhje me të gjithë personat, grupet dhe subjektet në listë për efektin që ata kanë janë përfshirë në akte terroriste sipas kuptimit të nenit 1 (2) dhe (3) të Pozicionit të Përbashkët 2001/931/CFSP. Këshilli ka arritur gjithashtu në përfundimin se personat, grupet dhe entitetet ndaj të cilëve zbatohen nenet 2, 3 dhe 4 të pozicionit të përbashkët 2001/931/CFSP duhet të vazhdojnë t'u nënshtrohen masave specifike kufizuese të parashikuara në pozicionin e përbashkët 2001/931/CFSP..
- (6) Lista duhet të përditësohet në përputhje me rrethanat, dhe Vendimi (CFSP) 2022/1241 duhet të shfuqizohet,

KA MIRATUAR KËTË VENDIM:

Neni 1

Lista e personave, grupeve dhe subjekteve për të cilat zbatohen nenet 2, 3 dhe 4 të pozicionit të përbashkët 2001/931/CFSP është paraqitur në shtojcën e këtij vendimi.

Neni 2

Vendimi (CFSP) 2022/1241 shfuqizohet.

(1) Pozicioni i përbashkët i Këshillit 2001/931/CFSP i 27 dhjetorit 2001 mbi zbatimin e masave specifike për të luftuar terrorizmin (OJ L 344, 28.12.2001, f. 93).

(2) Vendimi i Këshillit (CFSP) 2022/1241 i datës 18 korrik 2022 për përditësimin e listës së personave, grupeve dhe entiteteve që i nënshtrohen neneve 2, 3 dhe 4 të pozicionit të përbashkët 2001/931/CFSP mbi zbatimin e masave specifike për të luftuar terrorizmin, dhe shfuqizimin e Vendimit (CFSP) 2022/152 (OJ L 190, 19.7.2022, f. 133).



Neni 3

Ky Vendim hyn në fuqi një ditë pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Bashkimit Evropian.

Bërë në Bruksel, 24 shkurt 2023.

Për Këshillin
President
J. ROSWALL



SHTOJCA

LISTA E PERSONAVE, GRUPEVE DHE SUBJEKTEVE TË REFERUARA NË NENIN 1

I. PERSONA

1. ABDOLLAHI Hamed (a.k.a. Mustafâ Abdullahi), i lindur më 11.8.1960 në Iran. Numri i pasaportës: D9004878.
2. AL-NASSER Abdelkarim Hussein Mohamed, lindur në Al Ihsa (Arabia Saudite), shtetas i Arabisë Saudite.
3. AL-YACOUB Ibrahim Salih Mohammed, i lindur më 16.10.1966 në Tarut (Arabia Saudite), shtetas i Arabisë Saudite.
4. ARBABSIAR Manssor (a.k.a. Mansour Arbabsiar), i lindur më 6.3.1955 ose 15.3.1955 në Iran. Shtetasi iranian dhe amerikan, numri i pasaportës: C2002515 (Iran); numri i pasaportës: 477845448 (SHBA). Numri i ID-së kombëtare: 07442833, data e skadencës 15.3.2016 (patent shoferi në SHBA).
5. ASSADI Assadollah (a.k.a. Assadollah Asadi), i lindur më 22.12.1971 në Teheran (Iran), shtetas iranian. Numri i pasaportës diplomatike iraniane: D9016657.
6. BOUYERI Mohammed (a.k.a. Abu Zubair, a.k.a. Sobiâr, a.k.a. Abu Zoubair), i lindur më 8.3.1978 në Amsterdam (Holandë).
7. EL HAJJ Hassan Hassan, i lindur më 22.3.1988 në Zaghdrayya, Sidon, Liban, shtetas kanadez. Numri i pasaportës: JX446643 (Kanada).
8. HASHEMI MOGHADAM Saeid, lindur më 6.8.1962 në Teheran (Iran), shtetas iranian. Numri i pasaportës: D9016290, i vlefshëm deri më 4.2.2019.
9. AL-DIN Hasan Izz (a.k.a. Garbaya Ahmed, a.k.a. Sa'îd, a.k.a. Salwwan Samir), Liban, lindur më 1963 në Liban, shtetas i Libanit.
10. MELIAD Farah, lindur më 5.11.1980 në Sydney (Australi), shtetas australian. Numri i pasaportës: M2719127 (Australi).
11. MOHAMMED Khalid Sheikh (a.k.a. Ali Salem, i njohur si Bin Khalid Fahd Bin Abdallah, a.k.a. Henin Ashraf Refaat Nabith, a.k.a. Wadood Khalid Abdul), i lindur më 14.4.1965 ose 1.454,58 në Pakistan me numrin 1.3.8.
12. SHAHLAI Abdul Reza (a.k.a. Abdol Reza Shala'i, a.k.a. Abd-al Reza Shalai, a.k.a. Abdorreza Shahlai, a.k.a. Abdolreza Shahlai, a.k.a. Abdul-Reza Shahlaee, a.k.a. Hajxhif, Yuajif a.k.a., a.k. Yusuf, i njohur si Jusuf Abu-al-Karkh), i lindur rreth vitit 1957 në Iran. Adresat: (1) Kermanshah, Iran, (2) Baza Ushtarake Mehran, Provinca Ilam, Iran.
13. SHAKURI Ali Gholam, i lindur rreth vitit 1965 në Teheran, Iran.

II. GRUPET DHE ENTITETET

1. Organizata 'Abu Nidal' - 'ANO' (a.k.a. 'Këshilli Revolucionar i Fatahut', a.k.a. 'Brigadat Revolucionare Arabe', a.k.a. 'Shtatori i Zi', a.k.a. 'Organizata Revolucionare e Muslimanëve Socialistë').
2. Brigada e dëshmorëve të Al-Aksës.
3. 'El-Aksa e.V'.
4. 'Babbar Khalsa'.
5. 'Partia Komuniste e Filipineve', duke përfshirë 'Ushtrinë e Re Popullore' - 'NPA', Filipine.
6. Drejtoria për Sigurinë e Brendshme të Ministrisë iraniane për Inteligjencë dhe Siguri.
7. 'Gama'a el-Islamiyya' (a.k.a. 'Al-Gama'a al-Islamiyya') ('Grupi Islamik' - 'IG').
8. 'islami Buyuk Dogu Akincilar Cephesi' - 'IBDA-C' ('Fronti i Madh i Luftëtarëve të Lindjes Islamiqe').
9. 'Hamasi', duke përfshirë 'Hamasi-Izz al-Din al-Kassem'.



10. 'Krahu Ushtarak i Hizbollahut' (a.k.a. 'Krahu Ushtarak i Hezbollahut', a.k.a. 'Kragu Ushtarak i Hizbullahut', i njohur ndryshe si 'krahu ushtarak i Hizbollahut', a.k.a. 'krahu ushtarak i Hezbollahut', a.k.a. 'A.k.a. 'Krahu Ushtarak i Hizb Allah', a.k.a. 'Këshilli i Xhihadit' (dhe të gjitha njësitë që i raportojnë atij, duke përfshirë Organizatën e Sigurisë së Jashtme)).
11. 'Hizbul Muxhalidin' – 'HM'.
12. 'Khalistan Zindabad Force' – 'KZF'.
13. 'Partia e Punëtorëve të Kurdistanit' - 'PKK' (a.k.a. 'KADEK', a.k.a. 'KONGRA-GEL').
14. 'Tigrat e çlirimit të Tamil Eelam' - 'LTTE'.
15. 'Ejercito de Liberation National' ('Ushtria Çlirimtare Kombëtare').
16. 'Xhihadi Islamik Palestinez' – 'PIJ'.
17. 'Fronti Popullor për Çlirimin e Palestinës' – 'PFLP'.
18. "Fronti Popullor për Çlirimin e Palestinës - Komanda e Përgjithshme" (a.k.a. "PFLP - Komanda e Përgjithshme").
19. 'Devrimci Halk Kurtulus Partisi-Cephesi' - 'DHKP/C' (a.k.a. 'Devrimci Sol' ('E majta Revolucionare'), a.k.a. 'Dev Sol') ('Ushtria/Fronti/Partia Revolucionare Popullore Çlirimtare').
20. 'Sendero Luminoso' - 'SL' ('Shtegu i ndritshëm').
21. 'Teyrbazen Azadiya Kurdistan' - 'TAK' (a.k.a. 'Skifterat e Lirisë së Kurdistanit', a.k.a. 'Skifterat e Lirisë së Kurdistanit').

**COUNCIL DECISION (CFSP) 2023/422****of 24 February 2023****updating the list of persons, groups and entities subject to Articles 2, 3 and 4 of Common Position 2001/931/CFSP on the application of specific measures to combat terrorism, and repealing Decision (CFSP) 2022/1241**

THE COUNCIL OF THE EUROPEAN UNION,

Having regard to the Treaty on European Union, and in particular Article 29 thereof,

Having regard to the proposal from the High Representative of the Union for Foreign Affairs and Security Policy,

Whereas:

- (1) On 27 December 2001, the Council adopted Common Position 2001/931/CFSP ⁽¹⁾.
- (2) On 18 July 2022, the Council adopted Decision (CFSP) 2022/1241 ⁽²⁾, updating the list of persons, groups and entities subject to Articles 2, 3 and 4 of Common Position 2001/931/CFSP ('the list').
- (3) In accordance with Article 1(6) of Common Position 2001/931/CFSP, it is necessary to review at regular intervals the names of persons, groups and entities in the list to ensure that there are grounds for keeping them thereon.
- (4) This Decision sets out the result of the review that the Council has carried out in respect of persons, groups and entities to which Articles 2, 3 and 4 of Common Position 2001/931/CFSP apply.
- (5) The Council has verified that competent authorities, as referred to in Article 1(4) of Common Position 2001/931/CFSP, have taken decisions with regard to all persons, groups and entities on the list to the effect that they have been involved in terrorist acts within the meaning of Article 1(2) and (3) of Common Position 2001/931/CFSP. The Council has also concluded that the persons, groups and entities to which Articles 2, 3 and 4 of Common Position 2001/931/CFSP apply should continue to be subject to the specific restrictive measures provided for in Common Position 2001/931/CFSP.
- (6) The list should be updated accordingly, and Decision (CFSP) 2022/1241 should be repealed,

HAS ADOPTED THIS DECISION:

Article 1

The list of persons, groups and entities to which Articles 2, 3 and 4 of Common Position 2001/931/CFSP apply is set out in the Annex to this Decision.

Article 2

Decision (CFSP) 2022/1241 is hereby repealed.

⁽¹⁾ Council Common Position 2001/931/CFSP of 27 December 2001 on the application of specific measures to combat terrorism (OJ L 344, 28.12.2001, p. 93).

⁽²⁾ Council Decision (CFSP) 2022/1241 of 18 July 2022 updating the list of persons, groups and entities subject to Articles 2, 3 and 4 of Common Position 2001/931/CFSP on the application of specific measures to combat terrorism, and repealing Decision (CFSP) 2022/152 (OJ L 190, 19.7.2022, p. 133).



Article 3

This Decision shall enter into force on the day following that of its publication in the *Official Journal of the European Union*.

Done at Brussels, 24 February 2023.

For the Council
The President
J. ROSWALL



ANNEX

LIST OF PERSONS, GROUPS AND ENTITIES REFERRED TO IN ARTICLE 1

I. PERSONS

1. ABDOLLAHI Hamed (a.k.a. Mustafa Abdullahi), born 11.8.1960 in Iran. Passport number: D9004878.
2. AL-NASSER Abdelkarim Hussein Mohamed, born in Al Ihsa (Saudi Arabia), citizen of Saudi Arabia.
3. AL-YACOUB Ibrahim Salih Mohammed, born 16.10.1966 in Tarut (Saudi Arabia), citizen of Saudi Arabia.
4. ARBABSAR Mansour (a.k.a. Mansour Arbabsar), born 6.3.1955 or 15.3.1955 in Iran. Iranian and US national, passport number: C2002515 (Iran); passport number: 477845448 (USA). National ID number: 07442833, expiry date 15.3.2016 (USA driving licence).
5. ASSADI Assadollah (a.k.a. Assadollah Asadi), born 22.12.1971 in Teheran (Iran), Iranian national. Iranian diplomatic passport number: D9016657.
6. BOUYERI Mohammed (a.k.a. Abu Zubair, a.k.a. Sobiar, a.k.a. Abu Zoubair), born 8.3.1978 in Amsterdam (The Netherlands).
7. EL HAJJ Hassan Hassan, born 22.3.1988 in Zaghdrayya, Sidon, Lebanon, Canadian citizen. Passport number: JX446643 (Canada).
8. HASHEMI MOGHADAM Saeid, born 6.8.1962 in Teheran (Iran), Iranian national. Passport number: D9016290, valid until 4.2.2019.
9. AL-DIN Hasan Izz (a.k.a. Garbaya Ahmed, a.k.a. Sa'ïd, a.k.a. Salwwan Samir), Lebanon, born 1963 in Lebanon, citizen of Lebanon.
10. MELIAD Farah, born 5.11.1980 in Sydney (Australia), Australian citizen. Passport number: M2719127 (Australia).
11. MOHAMMED Khalid Sheikh (a.k.a. Ali Salem, a.k.a. Bin Khalid Fahd Bin Abdallah, a.k.a. Henin Ashraf Refaat Nabith, a.k.a. Wadood Khalid Abdul), born 14.4.1965 or 1.3.1964 in Pakistan, passport number: 488555.
12. SHAHLAI Abdul Reza (a.k.a. Abdol Reza Shala'i, a.k.a. Abd-al Reza Shalai, a.k.a. Abdorreza Shahlai, a.k.a. Abdolreza Shahla'i, a.k.a. Abdul-Reza Shahlaee, a.k.a. Hajj Yusef, a.k.a. Haji Yusif, a.k.a. Hajji Yasir, a.k.a. Hajji Yusif, a.k.a. Yusuf Abu-al-Karkh), born circa 1957 in Iran. Addresses: (1) Kermanshah, Iran, (2) Mehran Military Base, Ilam Province, Iran.
13. SHAKURI Ali Gholam, born circa 1965 in Tehran, Iran.

II. GROUPS AND ENTITIES

1. 'Abu Nidal Organisation' – 'ANO' (a.k.a. 'Fatah Revolutionary Council', a.k.a. 'Arab Revolutionary Brigades', a.k.a. 'Black September', a.k.a. 'Revolutionary Organisation of Socialist Muslims').
2. 'Al-Aqsa Martyrs' Brigade'.
3. 'Al-Aqsa e.V.'.
4. 'Babbar Khalsa'.
5. 'Communist Party of the Philippines', including 'New People's Army' – 'NPA', Philippines.
6. Directorate for Internal Security of the Iranian Ministry for Intelligence and Security.



7. 'Gama'a al-Islamiyya' (a.k.a. 'Al-Gama'a al-Islamiyya') ('Islamic Group' – 'IG').
8. 'İslami Büyük Doğu Akıncılar Cephesi' – 'İBDA-C' ('Great Islamic Eastern Warriors Front').
9. 'Hamas', including 'Hamas-Izz al-Din al-Qassem'.
10. 'Hizballah Military Wing' (a.k.a. 'Hezbollah Military Wing', a.k.a. 'Hizbullah Military Wing', a.k.a. 'Hizbollah Military Wing', a.k.a. 'Hezbollah Military Wing', a.k.a. 'Hisbollah Military Wing', a.k.a. 'Hizbu'llah Military Wing' a.k.a. 'Hizb Allah Military Wing', a.k.a. 'Jihad Council' (and all units reporting to it, including the External Security Organisation)).
11. 'Hizbul Mujahideen' – 'HM'.
12. 'Khalistan Zindabad Force' – 'KZF'.
13. 'Kurdistan Workers' Party' – 'PKK' (a.k.a. 'KADEK', a.k.a. 'KONGRA-GEL').
14. 'Liberation Tigers of Tamil Eelam' – 'LTTE'.
15. 'Ejército de Liberación Nacional' ('National Liberation Army').
16. 'Palestinian Islamic Jihad' – 'PIJ'.
17. 'Popular Front for the Liberation of Palestine' – 'PFLP'.
18. 'Popular Front for the Liberation of Palestine – General Command' (a.k.a. 'PFLP – General Command').
19. 'Devrimci Halk Kurtuluş Partisi-Cephesi' – 'DHKP/C' (a.k.a. 'Devrimci Sol' ('Revolutionary Left'), a.k.a. 'Dev Sol') ('Revolutionary People's Liberation Army/Front/Party').
20. 'Sendero Luminoso' – 'SL' ('Shining Path').
21. 'Teyrbazen Azadiya Kurdistan' – 'TAK' (a.k.a. 'Kurdistan Freedom Falcons', a.k.a. 'Kurdistan Freedom Hawks').

VENDIM

Nr. 264, datë 27.4.2023

PËR MIRATIMIN E PROCEDURAVE, KRITEREVE DHE RREGULLAVE PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT TË NXITJES SË PUNËSIMIT, SIPAS SKEMËS SË GARANCISË RINORE NËPËRMJET TË NXËNIT NË VENDIN E PUNËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 2, shkronja "g", e 4, të nenit 11, të ligjit nr. 15/2019 "Për nxitjen e punësimit", me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Ky vendim përcakton procedurat, kriteret dhe rregullat për zbatimin e programit të nxitjes së

punësimit, sipas skemës së garancisë rinore nëpërmjet të nxënit në vendin e punës për të rinjtë.

2. Programi i nxitjes së punësimit, sipas skemës së garancisë rinore, ka për qëllim përfshirjen në tregun e punës të të rinjve të moshës 15–29 vjeç, që nuk janë në punësim, arsim ose formim profesional, nëpërmjet të nxënit në vendin e punës.

3. Ministri përgjegjës për çështjet e punësimit dhe aftësive miraton planin e shpërndarjes së fondeve dhe pjesëmarrësve në programin e nxitjes së punësimit dhe rajonet, ku do të zbatohet programi në bazë të planit të zbatimit të garancisë rinore, pas propozimit nga institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë.

4. Zbatimi i këtij programi do të realizohet në përputhje me parimet e bashkëpunimit dhe sigurimit të cilësisë në sistemin e arsimit e formimit profesional (AFP).

5. Ofrimi i këtij programi realizohet në bashkëpunim të ngushtë ndërmjet punëdhënësve,



të rinjve pjesëmarrës, strukturave rajonale të punësimit dhe institucioneve publike ofruese të AFP-së.

6. Ky program zbatohet bazuar në një proces të drejtë dhe konkurrues aplikimi.

7. Ky program zbatohet dhe administrohet nga Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësi.

II. PROGRAMI

1. Programi i nxitjes së punësimit, sipas skemës të garancisë rinore, realizohet me anë të kurseve 3 deri në 6-mujore të formimit profesional nëpërmjet të nxënimit në vendin e punës dhe më pas punësimit për 6 (gjashtë) muaj të tjerë.

2. Të rinjtë pjesëmarrës në këtë program (kursantët) angazhohen për pjesën praktike të kursit, deri në 32 (tridhjetë e dy) orë mësimore në javë, gjatë 4 (katër) ditëve të javës. Për kursantët nën 18 vjeç zbatohen kushtet e punësimit në përputhje me rregulloren për mbrojtjen e fëmijëve në punë (miratuar me vendimin nr. 108, datë 15.2.2017, të Këshillit të Ministrave. Një ditë në javë, kursantët do të plotësojnë formimin teorik profesional, për 4 (katër) orë mësimore, pranë një ofruesi publik të AFP-së.

3. Për qëllim të zbatimit të programit të nxitjes së punësimit, sipas skemës së garancisë rinore, nëpërmjet të nxënimit në vendin e punës, hartohen programe të kurseve të formimit profesional, të përshtatshme për të rinjtë pjesëmarrës, në përputhje me profilet profesionale dhe kriteret e njoftuara në thirrjen përkatëse.

4. Programet e kurseve të formimit profesional miratohen nga një komision i përbërë nga drejtori i AFP-së në AKPA, një përfaqësues nga AKAFPK-ja dhe drejtori i ofruesit të AFP-së.

5. Institucioni ofrues publik i AFP-së mbikëqyr zbatimin e pjesës praktike të kursit të formimit profesional, plotësimin e formimit teorik profesional dhe vlerësimin e vazhduar e përfundimtar të kursantëve nëpërmjet angazhimit të mësimdhënësit të institucionit publik ofrues të AFP-së, në bashkëpunim me instruktorin në biznes.

6. Mësimdhënësi i institucionit ofrues publik i AFP-së angazhohet:

- një ditë në javë për katër orë mësimore për kursin teorik pranë institucionit ofrues publik të AFP-së për plotësimin e formimit teorik;

- 4 (katër) orë mësimore në javë për mbikëqyrjen e kursantëve në vendin e punës në subjekt;

- për vlerësimin e tyre në fund të periudhës së kursit të formimit profesional të të nxënimit në vendin e punës.

7. Në përfundim të programit të kursit profesional, kursantët vlerësohen dhe pajisen me dokumentin e certifikimit, në përputhje me udhëzimet përkatëse të legjislacionit të AFP-së për vlerësimin, provimet dhe certifikimin për kurset e veçanta.

III. PROCEDURAT, RREGULLAT DHE KRITERET E APLIKIMIT DHE TË PËRFITIMIT TË PROGRAMIT

1. Të drejtën e përfitimit nga ky program e kanë të gjithë të rinjtë, referuar në pikën 2, të kreut I, të këtij vendimi, të regjistruar prej jo më shumë se 4 (katër) muajsh në strukturën përkatëse të punësimit.

2. Kanë të drejtë të përfitojnë nga ky program punëdhënësit e regjistruar në strukturën përkatëse të punësimit, që veprojnë si persona fizikë e juridikë.

3. Punëdhënësit duhet të plotësojnë njëkohësisht kriteret e mëposhtme:

a) Të jenë të regjistruar prej jo më pak se 6 (gjashtë) muajsh;

b) Janë aktivë dhe nuk janë në proces falimentimi;

c) Vetëdeklarojnë se nuk kanë të regjistruar shkelje të legjislacionit të punës për të paktën 2 vitet e fundit;

ç) Nuk kanë detyrime tatimore të prapambetura;

d) Vetëdeklarojnë se disponojnë burime njerëzore dhe infrastrukturore në mbështetje të këtij programi;

dh) Vetëdeklarojnë se kanë vende të lira pune.

4. Pozicionet e punës, në të cilat do të angazhohen kursantët, në kuadër të këtij programi, janë pozicione të lira pune, në të cilat kursantët do të punojnë edhe për të paktën 6 (gjashtë) muaj të tjerë pas përfundimit të programit të nxitjes së punësimit, sipas skemës së garancisë rinore, nëpërmjet të nxënimit në vendin e punës. Përgjatë këtyre 6 (gjashtë) muajve të punësimit, punëmarrësit do të paguhet nga punëdhënësi të paktën me pagë minimale në shkallë vendi.

5. Punëdhënësit kanë detyrimin të caktojnë të paktën një instruktor për çdo grup përfituesish me



deri në 5 (pesë) punëkërkuar të papunë në varësi të kapaciteteve dhe vendeve të lira të punës.

Në rast të largimit të instruktorit, punëdhënësi ka detyrim të njoftojë brenda 5 (pesë) ditëve pune strukturën përkatëse të punësimit në lidhje me largimin dhe zëvendësimin e tij/saj në përputhje me kriteret profesionale të parashikuara në pikën 6, të kreut III, të këtij vendimi.

6. Personi, i cili angazhohet si instruktor në biznes, përzgjidhet nga punëdhënësi dhe duhet të jetë staf i punësuar pranë tij. Instruktori në biznes duhet të plotësojë këto kriteret profesionale dhe personale, si më poshtë vijon:

a) Të ketë përvojë pune të paktën 3 (tre) vjet në profesione që lidhen me programin e praktikës profesionale të biznesit;

b) Të zotërojë aftësi të mira organizative, planifikuese dhe komunikimi;

c) Të jetë i/e aftë të udhëheqë dhe të mbikëqyrë ecurinë e kursantëve për përvetësimin e aftësive profesionale gjatë kohëzgjatjes së programit të të nxëniet në vendin e punës;

ç) Të jetë i/e aftë të vlerësojë ecurinë dhe arritjet e kursantëve.

7. Instruktori në biznes ka për detyrë të këshillojë, të drejtojë e të ndihmojë kursantët për t'u aftësuar në punë e procese, të përcaktuara sipas programit të formimit profesional dhe të bëjë vlerësimin dhe raportimin e ecurisë së kursantëve.

IV. MBËSHITETJA E PËRFITUESVE

1. Kursantët, pjesëmarrës në këtë program, përfitojnë:

a) bonus transporti, në vlerën 1 600 (një mijë e gjashtëqind) lekë në muaj, për të gjithë kohëzgjatjen, për mbulimin e shpenzimeve të transportit, në rast se banojnë më shumë se 2 (dy) km larg vendit të punës. Paga e bonusit të shpenzimeve të transportit bëhet çdo muaj në llogarinë e kursantit;

b) pagesë për pjesëmarrje në kursin e formimit profesional, në masën 80% të pagës minimale në shkallë vendi gjatë gjysmës së parë të kursit dhe 100% të pagës minimale në shkallë vendi për pjesën e mbetur. Paga për pjesëmarrje do të bëhet çdo muaj në llogarinë e kursantit.

2. Punëdhënësit, pjesëmarrës në program, rimbursohen për kategoritë e mëposhtme të shpenzimeve:

a) Pagesën e instruktorit në biznes, i cili do të angazhohet në masën 20% të kohëzgjatjes normale

ditore të punës, për çdo grup prej 5 (pesë) kursantësh. Paga mësimore orare e instruktorit në biznes nuk mund të kalojë pagesën mësimore orare të një instruktorit në institucionet publike të AFP-së, sipas legjislacionit përkatës;

b) Pagesën për sigurimin e kursantit për aksidente në punë gjatë kohëzgjatjes së kursit të formimit profesional;

c) Pagesën për sigurimet e detyrueshme shoqërore dhe shëndetësore, në masën e pagës minimale për 6 (gjashtë) muajt e tjerë të punësimit.

3. Punëkërkuarët e papunë, pjesëmarrës në këtë program, nuk mund të zëvendësohen dhe kanë të drejtë të marrin pjesë vetëm një herë në këtë program.

V. PROCEDURAT E NJOFTIMIT DHE ZBATIMIT TË PROGRAMIT

1. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë, nëpërmjet strukturave të tij, publikon informacionin e nevojshëm në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në platforma të tjera (faqe interneti, media sociale, shtyp, tryeza diskutimesh etj.) lidhur me zbatimin e programeve dhe informon punëdhënësit e punëkërkuarët të regjistruar.

2. Institucionet publike ofruese të AFP-së, nëpërmjet njësive të tyre të zhvillimit, promovojnë këtë program dhe informojnë punëdhënësit me të cilët kanë bashkëpunim.

3. Çdo thirrje për kërkesë pjesëmarrjeje në këtë program përmban kriteret e kërkesës, fushat dhe vlerat e financimit, kriteret e pjesëmarrjes, procedurën e vlerësimit dhe njoftimit, afatet e aplikimit, si edhe dokumentet shoqëruese që kërkohen në kuadër të kërkesës.

4. Punëdhënësit paraqesin kërkesën për përfshirjen në program nëpërmjet portalit qeveritar “e-Albania”, duke ngarkuar dokumentacionin e mëposhtëm:

a) Formularin e kërkesës të plotësuar, sipas modelit standard, të miratuar dhe publikuar nga institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë;

b) Autorizimin e punëdhënësit, me të cilin autorizohet institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë për të kryer të gjitha verifikimet dhe kërkimet e nevojshme të dokumenteve dhe të të dhënave të kërkesës;

c) Vetëdeklarimin për mospasjen në ngarkim të punëdhënësit të shkeljeve apo të sanksioneve që



lidhen me legjislacionin e punës, përgjatë dy viteve të fundit;

ç) vetëdeklarimin se disponojnë burime njerëzore dhe infrastrukturore në mbështetje të këtij programi.

5. Struktura përkatëse e punësimit, brenda 7 (shtatë) ditëve pune nga marrja e kërkesës nëpërmjet portalit qeveritar *e-Albania*, verifikon plotësimin e kriterëve nga kërkuesit dhe shqyrton dokumentet mbështetëse të paraqitura prej tyre, nëpërmjet dokumenteve të mëposhtme:

a) Ekstraktit historik të punëdhënësit, të lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit;

b) Vërtetimit për pagimin e detyrimeve tatimore;

c) Vërtetimit për derdhjen e kontributeve shoqërore e shëndetësore për tatimpaguesin për 12 (dymbëdhjetë) muajt e fundit.

6. Në rast të mangësive në informacion dhe dokumentacion kërkohet që aplikantët të bëjnë plotësimin e tyre, në mënyrë elektronike, brenda një afati të caktuar që nuk mund të jetë më shumë se 3 (tri) ditë pune.

7. Në përfundim të procedurës së verifikimit, struktura përkatëse e evidenton punëdhënësit që plotësojnë kriteret dhe i dërgon pranë institucioneve ofruesve publike të AFP-së për të hartuar dhe finalizuar programin e trajnimit, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve kalendarike.

8. Pasi punëdhënësi ka finalizuar programin e trajnimit, struktura përkatëse e punësimit harton listën e punëkërkuësve të papunë, që plotësojnë kriteret për pjesëmarrje në këtë program brenda 7 (shtatë) ditëve pune.

9. Në strukturën përkatëse të punësimit ngrihet komisioni i miratimit të projekteve, i cili përbëhet nga të paktën 3 (tre) anëtarë, njëri prej të cilëve është përfaqësues i institucioneve ofruese publike të AFP-së. Komisioni ka për detyrë që brenda 5 (pesë) ditëve pune të shqyrtojë projektet e nxitjes së punësimit të të nxëniet nëpërmjet punës, duke pasur në vëmendje programin, kapacitetet trajnuese të punëdhënësit, si dhe fondin në dispozicion për këtë thirrje.

10. Struktura përkatëse e punësimit njofton punëdhënësin brenda 2 (dy) ditëve pune për miratimin ose refuzimin e aplikimit të tij.

11. Për kursantët, të cilët janë përfytyes të skemës së ndihmës ekonomike, struktura rajonale e

punësimit kryen njoftimin përkatës në njësinë përgjegjëse të shërbimit social.

12. Të drejtat dhe detyrimet e palëve të përfshira në zbatimin e këtij programi do të përcaktohen në bazë të një marrëveshjeje 4-palëshe (katërpalëshe), ndërmjet strukturës përkatëse rajonale të punësimit, punëdhënësit, kursantit ose prindit/kujdestarit ligjor dhe institucionit ofrues të AFP-së, në përputhje me dispozitat e Kodit të Punës, si dhe legjislacionit për nxitjen e punësimit dhe AFP-në. Modeli i marrëveshjes hartohet nga institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë.

13. Në rast të mospërbushjes së detyrimeve kontraktuale nga punëdhënësi, ai detyrohet të kthejë 100% të subvencionit të përfituar dhe përjashtohet nga përfshirja në këtë program për të paktën 3 (tre) vjet. Në këtë rast, kursanti dhe ofruesi publik i AFP-së duhet të njoftojnë menjëherë strukturën rajonale të punësimit.

14. Në rast se punëdhënësi e zgjidh kontratën përpara përfundimit të programit, për shkaqe të arsyeshme dhe të justifikuara, që lidhen me thyerjen e rregullave të etikës e sjelljes nga ana e kursantit dhe shkelje në mënyrë të përsëritur të rregullores së brendshme të punëdhënësit, ky i fundit nuk ka detyrim për të kthyer shumën e përfituar nga programi, deri në datën kur ka njoftuar palët për zgjidhjen e kontratës.

15. Zbatimi i këtij programi do të monitorohet nga strukturat përkatëse të punësimit dhe institucionet ofruese publike të AFP-së.

VI. DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

1. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, përballohen nga buxheti i miratuar për Agjencinë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive, në programin “Tregu i punës”, të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë.

2. Institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë përgatit raportin vjetor për zbatimin e këtij programi, brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, dhe ia paraqet ministrisë përgjegjëse për çështjet e punësimit dhe strukturës përgjegjëse të ndihmës shtetërore.

3. Vlerësimi i ndikimit të programeve kryhet çdo 4 (katër) vjet nga ministria përgjegjëse për çështjet e punësimit, nëpërmjet ekspertëve ose organizatave me përvojë në këtë fushë.

4. Afati i zbatimit të këtij programi është 5 (pesë) vjet nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.



5. Ngarkohet institucioni përgjegjës për punësimin dhe aftësitë për hartimin e rregullores të zbatimit të programit të nxitjes së punësimit, sipas këtij vendimi, e cila miratohet nga titullari brenda 3 (tre) muajve nga hyrja në fuqi e këtij vendimi.

6. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 265, datë 27.4.2023

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 1039, DATË 4.12.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË PUNËS DHE PËR CAKTIMIN E PËRFAQËSUESVE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NË KËTË KËSHILL”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 200, të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995, “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. Në vendimin nr. 1039, datë 4.12.2013, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 9 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“9. Pranë KKP-së krijohen dhe funksionojnë komisionet e përhershme e të specializuara tripalëshe, me përbërje, si më poshtë vijon:

a) Komisioni juridik kryesohet nga drejtori i Drejtorisë së Programimit, Standardizimit dhe Harmonizimit të Kuadrit Rregullator në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe ka në përbërje anëtarë, përfaqësues nga:

- i. Ministria e Drejtësisë;
- ii. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH);

iii. Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH);

iv. Biznesalbania;

v. shoqata “Bashkimi i Prodhuesve Shqiptarë”.

b) Komisioni i punësimit, arsimit dhe formimit profesional kryesohet nga drejtori i Drejtorisë së Punësimit, Arsimit dhe Formimit Profesional në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe ka në përbërje anëtarë, përfaqësues nga:

i. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përgjegjës sektori i PAFP-së;

ii. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH);

iii. Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH);

iv. Biznesalbania;

v. Shoqata e Bukës, Pastiçerisë dhe Brumërave.

c) Komisioni i pagave, pensione dhe përkrahjes sociale kryesohet nga drejtori i Drejtorisë së Pensioneve dhe Pagës Minimale në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe ka në përbërje anëtarë, përfaqësues nga:

i. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, drejtori i Drejtorisë së Buxhetit;

ii. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH);

iii. Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH);

iv. Biznesalbania;

v. Dhoma Kombëtare e Prodhuesve të Veshjeve/Këpucëve-Proeksport.

ç) Komisioni i kushteve të punës, shëndetit dhe sigurimit në punë kryesohet nga drejtori i Drejtorisë së Inspektimit dhe Marrëdhënieve të Punës në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe ka në përbërje anëtarë, përfaqësues nga:

i. ISHPSHSH-ja, nëndrejtori;

ii. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH);

iii. Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH);

iv. Biznesalbania;

v. Shoqata e Ndërtuesve të Shqipërisë.

d) Komisioni i ekonomisë dhe i financës kryesohet nga drejtori i Drejtorisë së Buxhetit i dhe Borxhit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë dhe ka në përbërje anëtarë, përfaqësues nga:

i. Ministria e Financave dhe Ekonomisë, përgjegjësi i sektorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Borxhit;



ii. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH);

iii. Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH);

iv. Biznesalbania;

v. Shoqata Shqiptare e Bankave.

dh) Komisioni i shanseve të barabarta, aftësive të kufizuara dhe rinisë kryesohet nga drejtori i Drejtorisë Përgjegjëse për Shanset e Barabarta dhe Aftësitë e Kufizuara në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe ka në përbërje anëtarë, përfaqësues nga:

i. Ministria e Arsimit dhe Sportit, drejtori i drejtorisë përgjegjëse për rininë;

ii. Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë (BSPSH);

iii. Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë (KSSH);

iv. Biznesalbania;

v. Shoqata Shqiptare e Turizmit.”

2. Pika 11 shfuqizohet.

II. Ngarkohet Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI

Belinda Balluku

VENDIM

Nr. 267, datë 27.4.2023

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 559, DATË 29.7.2022,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E ÇMIMEVE DHE
TARIFAVE PËR DHËNIEN NË
SHFRYTËZIM/PËRDORIM TË FONDIT
PYJOR KOMBËTAR PËR VEPRIMTARI
EKONOMIKE DHE PËR PRODHIMET
DRUSORE DHE JODRUSORE PYJORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13, pika 4, 25, pika 4, dhe 27, pika 5, të ligjit nr. 57/2020, “Për pyjet”, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit dhe të ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 559, datë 29.7.2022, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Titulli i vendimit ndryshohet dhe zëvendësohet me “Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dhënie në shfrytëzim/përdorim të Fondit PyJOR Kombëtar, për veprimtari ekonomike dhe prodhimet drusore e jodrusore pyjore, si dhe mënyrën e procedurën e mbledhjes së tyre”.

2. Në bazën ligjore, pas fjalës “... të neneve ...” shtohet togfjalëshi “... 13, pika 4, ...”.

3. Në pikën 1, pas fjalëve “... në Fondin PyJOR Kombëtar ...” shtohen “... dhe mënyrën e procedurën e mbledhjes së tyre ...”.

4. Pas pikës 5 shtohen pikat 5.1, 5.2, 5.3, 5.4, 5.5, 5.6 dhe 5.7, me këtë përmbajtje:

“5.1 Tarifat për dhënie në përdorim të fondit pyJOR, sipas shtojcës 1, të këtij vendimi, paguhet çdo vit, nga subjektet që marrin në përdorim fondin pyJOR, pavarësisht kohëzgjatjes së kontratës së qirasë për dhënie në përdorim të këtij fondi, të lidhur midis bashkisë, në territorin e së cilës kryhet aktiviteti, dhe subjektit fizik apo juridik që kryen aktivitetin.

5.2 Tarifa vjetore e përcaktuar në pikën 5.1, të këtij vendimi, paguhet në llogarinë bankare të bashkisë brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga dita e lidhjes së kontratës dhe në të njëjtën muaj për vitet në vijim.

5.3 Tarifat për sipërfaqen e shfrytëzuar për heqjen nga Fondi PyJOR Kombëtar përcaktohen në raportin tekniko-ekonomik për sipërfaqen pyjore që hiqet, të hartuar nga strukturat përgjegjëse për pyjet në bashki. Struktura përgjegjëse për pyjet në ministri, brenda 10 (dhjetë) ditëve nga miratimi i aktit të heqjes nga fondi pyJOR, njofton subjektin për kryerjen e pagesës së tarifës. Tarifa paguhet në llogarinë bankare të bashkisë brenda 10 (dhjetë) ditëve nga dita e njoftimit. Moskryerja e pagesës brenda afatit të përcaktuar përbën kusht për anulimin e aktit të miratimit të heqjes nga fondi pyJOR.

5.4 Tarifat për shfrytëzimin e Fondit PyJOR Kombëtar, sipas shtojcës 2, të këtij vendimi, për vendosjen e kampingjeve, qendrave dhe objekteve të lëvizshme janë ditore, bazuar në kontratat sezonale të shfrytëzimit dhe paguhet në momentin e lidhjes së kontratës në llogarinë bankare të bashkisë përkatëse.



5.5 Tarifat, që paguhen për shpërblimin e dëmit të shkaktuar në fondin pyjor, derdhen në llogarinë bankare të bashkisë përkatëse dhe mbledhja e tyre apo ekzekutimi i detyrueshëm bëhet sipas procedurës së përcaktuar në legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

5.6 Tarifat për prodhimet drusore dhe jodrusore pyjore dhe për grumbullimin e nxjerrjen e prodhimeve të dyta pyjore dhe jopyjore, sipas shtojcës 3 të këtij vendimi, paguhen pas shpalljes së fituesit në procedurat e konkurrimit publik dhe lidhjes së kontratës në llogarinë bankare të bashkisë përkatëse.

5.7 Kur veprimtaritë e sipërpërmendura zhvillohen në fondin pyjor privat mënyra dhe procedura e mbledhjes së tarifës përkatëse përcaktohet në marrëveshjen midis pronarit privat dhe subjektit të interesuar.”

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 268, datë 27.4.2023

**PËR DISA SHTESA DHE NDRYSHIME
NË VENDIMIN NR. 247, DATË 30.4.2014,
TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE, TË
KËRKESAVE E TË PROCEDURAVE PËR
INFORMIMIN DHE PËRFSHIRJEN E
PUBLIKUT NË VENDIMMARRJEN
MJEDISORE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 5, të nenit 17, të ligjit nr. 10 440, datë 7.7.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Turizmit dhe Mjedisit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr. 247, datë 30.4.2014, të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa dhe ndryshime:

1. Kudo në tekstin e vendimit:

a) emërtimi “Ministria e Mjedisit” zëvendësohet me fjalët “...ministra përgjegjëse për mjedis in ...”;

b) emërtimi “Agjencia Rajonale e Mjedisit” dhe shkurtimi “ARM” zëvendësohen, përkatësisht, me “Drejtoria Rajonale e Mjedisit” dhe “DRM”;

c) fjalët “... qeverisjes vendore ...” zëvendësohen me “... vetëqeverisjes vendore ...”;

ç) fjala “shënim” zëvendësohet me “proces-verbal”.

2. Në kreun I bëhen këto ndryshime:

a) Shkronja “a”, e pikës 1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“a) Informimin dhe marrjen e mendimit të publikut nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM) për projektet, që AKM-ja vlerëson se ato mund të kenë ndikim të konsiderueshëm në mjedis, bazuar në listën e shtojcës II, të ligjit nr. 10440 datë 7.11.2011, “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis”, të ndryshuar, të shoqëruar me sqarimet për procedurën në zbatim.”

b) Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2. Në rastet kur AKM-ja vlerëson se projekti ka ndikim të konsiderueshëm në mjedis, publikon menjëherë në faqen e saj të internetit informacionin e plotë për projektin, siç është paraqitur nga zhvilluesi.”

c) Shkronja “c”, e pikës 3, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“c) mënyrën dhe afatin e ankimit, brenda 30 ditëve nga publikimi i vendimit të titullari i AKM-së, ndaj vendimit dhe procedurës së zbatuar nga AKM-ja për marrjen e vendimit, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurës Administrative.”

ç) Pika 4 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“4. Në përfundim të procedurës paraprake të VNM-së, AKM-ja gjatë marrjes së vendimit vlerëson komentet apo sugjerimet e dhëna nga publiku/palët e interesuara për projektin dhe procedurën paraprake të ndjekur gjatë fazës, sipas shkronjës “a”, të pikës 1, të këtij kreu. Vendimi i AKM-së publikohet i plotë në faqen e saj të internetit, ku publiku dhe palët e tjera të interesuara sigurojnë një kopje të plotë të tij.”

3. Në kreun II bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

a) Shkronja “ç”, e pikës 2.1, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“ç) mënyrën e ushtrimit të së drejtës së ankimit ndaj procedurës së pjesëmarrjes së publikut dhe deklaratës mjedisore, brenda 30 ditëve nga publikimi i deklaratës.”



b) Në pikën 2.3, pas fjalëve “... njësitë administrative vendore ...” shtohen “... dhe palët e interesuara ...”;

c) Në fund të shkronjës “b”, të pikës 4.1, shtohen fjalët “... të paktën 20 (njëzet) ditë nga publikimi i informacionit të plotë mbi projektin e paraqitur në AKM.”;

ç) Shkronja “dh”, e pikës 4.2, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“dh) Merr në konsideratë rezultatet dhe sugjerimet e publikut apo argumenton arsyet e mosmarrjes në konsideratë të kërkesave të tyre gjatë shqyrtimit për deklaratën mjedisore dhe procesit të VNM-së.”;

d) Pas pikës 7.6 shtohet pika 7.7, me këtë përmbajtje:

“7.7 Procesi i zhvillimit të seancës dëgjimore për projektin e propozuar është i vlefshëm brenda 1 viti nga data e realizimit, kur:

i. zhvilluesi tërhiqet nga zhvillimi i projektit, pas përfundimit të procesit të dëgjësës publike;

ii. zhvilluesi është pajisur me deklaratë mjedisore për refuzimin e kërkesës për leje/licencë zhvillimi për atë projekt, shkaqet e së cilës nuk cenojnë interesat e publikut dhe palëve të interesuara, sipas procesverbaleve dhe raporteve të përgatitura gjatë procesit të zhvillimit të seancës dëgjimore. Në këtë rast, procesi i zhvillimit të seancës dëgjimore është i vlefshëm edhe kur zhvilluesi rifillon procedurën për pajisjen me deklaratë mjedisore, brenda 1 (një) viti nga realizimi i këtij procesi.”.

4. Pika 2.1, e kreut III, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2.1 Çdo palë e interesuar ka të drejtën e ankimit administrativ ndaj akteve, veprimeve apo mosveprimeve dhe/ose veprimit procedural gjatë zhvillimit të procedurës së informimit dhe pjesëmarrjes së publikut në procesin paraprak dhe të thelluar të VNM-së, në zbatim të legjislacionit në fuqi dhe Kodit të Procedurës Administrative. Ankimi administrativ paraqitet te ministri brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e shpalljes së deklaratës mjedisore.”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

VENDIM
Nr. 13, datë 21.3.2023

NË EMËR TË REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë,
e përbërë nga:

Holta Zaçaj	kryetare;
Marsida Xhaferllari	anëtare;
Fiona Papajorgji	anëtare;
Elsa Toska	anëtare;
Sandër Beci	anëtar;
Ilir Toska	anëtar;
Genti Ibrahim	anëtar;
Marjana Semini	anëtare;
Sonila Bejtja	anëtare,

me sekretare Belma Lleshi, në datën 21.3.2023 mori në shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve çështjen nr. 9 (E) 2022 të Regjistrat Themeltar, që u përket:

KËRKUES: Eduard Kelmendi

SUBJEKT I INTERESUAR: Bashkia Tiranë

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-1082 (189), datë 13.5.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtuësëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 131, pika 1, shkronja “P”, 134, pika 1, shkronja “i” dhe 135, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; nenet 6 dhe 46 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe neni 1 i Protokollit nr. 1 dhe neni 1 i Protokollit nr. 12 të saj; ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkuësit, i cili ka kërkuar pranimin e kërkesës, konstatoi mungesën e parashtrimeve të subjektit të interesuar, Bashkisë Tiranë, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,



VËREN:

I

Rrethanat e çështjes

1. Me urdhrin nr. 63, datë 3.8.2007 të kryetarit të njësisë bashkiake nr. 10, Tiranë, kërkuesi është emëruar në detyrën e nënkryetarit të asaj njësie. Ndërsa, me urdhrin nr. 11239, datë 21.8.2015 të kryetarit të Bashkisë Tiranë, është urdhëruar ndërprerja e marrëdhënies së punës së kërkuesit. Në këto kushte, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, me padë me objekt detyrimin e Bashkisë Tiranë ta dëmshpërblejë atë për shkak të mosrespektimit të afatit të njoftimit të parashikuar në Kodin e Punës.

2. Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me vendimin nr. 6161, datë 3.12.2015, ka vendosur pranimin e pjesëshëm të padisë dhe detyrimin e Bashkisë Tiranë të dëmshpërblejë kërkuesin në total me 19 paga mujore. Kundër këtij vendimi ka bërë ankim Bashkia Tiranë.

3. Gjykata Administrative e Apelit, me vendimin nr. 86 (93), datë 19.1.2018, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. 6161, datë 3.12.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Kundër këtij vendimi ka bërë rekurs Bashkia Tiranë.

4. Mbi kërkesën e subjektit të interesuar, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë (*Gjykata e Lartë*), me vendimin nr. 211, datë 17.4.2018, fillimisht ka vendosur pezullimin e vendimit nr. 6161, datë 3.12.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndërsa në gjykimin në themel të çështjes, në dhomën e këshillimit, me vendimin nr. 00-2022-1082 (189), datë 13.5.2022, ka vendosur prishjen e vendimeve të gjykatës së shkallës së parë dhe gjykatës së apelit, si dhe rrëzimin e padisë.

5. Në datën 13.9.2022 (sipas shënimit të shërbimit postar), kërkuesi i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*) me ankim kushtetues individual, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-1082 (189), datë 13.5.2022, të Gjykatës së Lartë. Në datën 24.11.2022 Kolegji i Gjykatës ka vendosur kalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare mbi bazë të dokumenteve.

II

Pretendimet në Gjykatën Kushtetuese

6. Kërkuesi, në mënyrë të përmbledhur, ka parashtruar se i janë cenuar:

6.1 *Parimi i kontradiktoritetit dhe e drejta për t'u dëgjuar*, pasi, sipas tij, Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar atë për datën dhe orën e zhvillimit të gjykimit dhe shtyrjen e tij. Ai është interesuar në ambientet e Gjykatës së Lartë, ku ajo bën shpalljen e gjykimeve, si dhe në faqen zyrtare, por në asnjërin prej tyre nuk rezulton të jetë njoftuar data dhe ora e gjykimit, si dhe shtyrja e këtij gjykimi për një datë tjetër.

6.2 *Standardi i arsyetimit të vendimit gjyqësor*, pasi vendimi i Gjykatës së Lartë është alogjik, i paarsyetuar dhe i njëanshëm. Në raste të ngjashme, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të bërë nga Bashkia Tiranë, ndërsa për rastin konkret ka ndryshuar vendimet e dy gjykatave më të ulëta, duke rrëzuar padinë dhe ndryshuar arsyetimin e vendimeve të saj. Gjykata e Lartë në arsyetimin e saj referon si shkak për ndryshimin e vendimeve të gjykatave natyrën e pozicionit të kërkuesit. Sipas këtij shkak, çështja duhej të kthehej për rigjykim që të rregullohej pikërisht ky moment ligjor material dhe procedural, por, në kundërshtim me këtë arsyetim, Gjykata e Lartë ka ndryshuar vendimet e gjykatave më të ulëta dhe ka rrëzuar padinë.

6.3 *Gjykimi nga një gjykatë e caktuar me ligj*, pasi Gjykata e Lartë ka kryer një rivlerësim të provave dhe fakteve duke i shtrembëruar ato dhe duke mbajtur një qëndrim të ndryshëm nga praktika e saj për çështje të ngjashme me atë të kërkuesit.

7. Subjekti i interesuar, Bashkia Tiranë, nuk ka paraqitur prapësime, megjithëse është njoftuar rregullisht nga Gjykata.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese*A. Për legjitimitimin e kërkuesit*

8. Çështja e legjitimitimit (*locus standi*) është vlerësuar nga Gjykata si një ndër aspektet kryesore që lidhet me inicimin e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “P” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekti i së drejtës private dhe



publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

9. Për sa i përket përmbushjes së këtyre kriterëve, kërkuesi legjitimohet *ratione personae*, bazuar në nenet 131, pika 1, shkronja “F” dhe 134, pika 1, shkronja “I”, të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor, ndaj të cilit ka ngritur pretendime në këtë Gjykatë dhe ka interes të drejtpërdrejtë në çështjen e parashtruar.

10. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, Gjykata ka pohuar se në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “F”, të Kushtetutës, ankuesi duhet të shfrytëzojë në shkallët e sistemit gjyqësor të gjitha mjetet e lejueshme dhe mundësitë procedurale për vendosjen në vend të të drejtave të pretenduara të shkelura. Mjetet ligjore shterojnë kur, në varësi të rrethanave të çështjes, rregullat procedurale nuk parashikojnë mjete të tjera ankimi (*shih vendimet nr. 7, datë 21.2.2023, nr. 10, datë 4.3.2021; nr. 56, datë 25.7.2017, të Gjykatës Kushtetuese*).

11. Në rastin konkret, kërkuesi i është drejtuar Gjykatës për shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-1082 (189), datë 13.5.2022, të Gjykatës së Lartë dhe nuk ka mjet tjetër për të shteruar. Për këtë arsye ai e plotëson këtë kriter.

12. Po kështu, Gjykata vlerëson se kërkuesi legjitimohet *ratione temporis*, pasi vendimi i kundërshtuar i Gjykatës së Lartë mban datën 13.5.2022, kurse ankimi kushtetues individual është dërguar nëpërmjet shërbimit postar në datën 13.9.2022, pra brenda afatit 4-mujor të parashikuar nga neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000.

13. Në drejtim të legjitimitimit *ratione materiae*, kërkuesi ka pretenduar se nga vendimi gjyqësor i kundërshtuar atij i është cenuar e drejta për një proces të rregullt ligjor në aspektet e parimit të kontradiktoritetit, së drejtës për t’u dëgjuar, si dhe standardit të arsyetimit dhe gjykimit nga një gjykatë

e caktuar me ligj. Në thelb, ai kundërshton rrëzimin e padisë nga Gjykata e Lartë, duke pretenduar se e drejta e tij për dëmshpërblim është njohur nga gjykata e shkallës së parë dhe gjykata e apelit, ndërsa Gjykata e Lartë, duke zhvilluar një proces jo të rregullt, ia ka mohuar këtë dëmshpërblim. Sipas kërkuetit, Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar për datën dhe orën e zhvillimit të gjykimit dhe vendimi i kundërshtuar nuk plotëson kriteret për arsyetimin e tij. Kërkuesi ka pretenduar, gjithashtu, se Gjykata e Lartë ka kryer një rivlerësim të provave dhe fakteve duke i shtrembëruar ato dhe ka mbajtur një qëndrim të ndryshëm nga praktika e saj për çështje të ngjashme.

14. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se argumentet lidhen me mënyrën e përfundimit të procesit gjyqësor të zhvilluar ndaj kërkuetit, çmanta analizojë çështjen e paraqitur në këndvështrim të nenit 42 të Kushtetutës, sipas të cilit një e drejtë e njohur me ligj nuk mund të cenohet pa një proces të rregullt ligjor dhe se kushdo, për mbrojtjen e saj, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë nga një gjykatë. Në vlerësimin e pretendimeve të kërkuetit, Gjykata evidenton se standardet kushtetuese që garantojnë procesin e rregullt ligjor dhe gjykimin e drejtë, janë ngushtësisht të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën, në mënyrë të tillë që cenimi edhe i vetëm njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave (*shih vendimet nr. 7, datë 21.2.2023; nr. 40, datë 22.12.2022, të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Për sa më lart, për të përcaktuar nëse kërkuetit i është cenuar e drejta për proces të rregullt ligjor, është e rëndësishme të analizohet në themel nëse procesi i zhvilluar nga Gjykata e Lartë, e cila ka dhënë vendimin e kundërshtuar, ka përmbushur standardet e procesit të rregullt në këndvështrim të parimit të kontradiktoritetit, së drejtës për t’u dëgjuar dhe standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor lidhur me mbrojtjen efektive.

B. Për themelin e pretendimeve

B.1. Për cenimin e parimit të kontradiktoritetit dhe së drejtës për t’u dëgjuar

16. Kërkuesi pretendon se Gjykata e Lartë nuk e ka njoftuar atë për datën dhe orën e zhvillimit të gjykimit dhe për shtyrjen e tij. Ai është interesuar në ambientet e Gjykatës së Lartë, ku ajo bën shpalljen e gjyqimeve, si dhe në faqen zyrtare të saj, por në asnjërin prej tyre nuk rezulton të jetë



njoftuar data dhe ora e gjykimit dhe shtyrja e këtij gjykimi për një datë tjetër.

17. Gjykata çmon të rrithekojë edhe një herë qëndrimin e saj se parimi i barazisë së armëve dhe kontradiktoritetit nënkupton se çdokush që është palë në proces duhet të ketë mundësi të barabarta që të paraqesë çështjen e tij. E drejta për të marrë pjesë në gjykim nuk duhet konsideruar si një e drejtë formale, ku palëve t'u garantohej thjesht prania fizike gjatë procesit civil, por duhet që legjislacioni procedural, në radhë të parë, dhe më pas gjyqtari gjatë gjykimit t'u japin mundësi të barabarta palëve për të paraqitur argumente dhe prova në mbrojtje të interesave të tyre. Nëse nuk do të ekzistonte barazia e armëve, atëherë argumentet e njëres palë do të prevalonin mbi argumentet e palës së cenuar dhe, për rrjedhojë, e drejta për të marrë pjesë në gjykim do të zhvishej nga funksioni i saj kushtetues për të garantuar një proces të rregullt ligjor. Bazuar në këto parime, Gjykatës i dalin një sërë detyrash, mes të cilave rëndësi të veçantë merr krijimi i mundësive të barabarta për pjesëmarrjen e palëve ose përfaqësuesve të tyre në proces, si dhe mundësia e deklaramit të tyre për faktet, provat dhe vlerësimet ligjore që janë të lidhura ngushtë me çështjen që shqyrtohet në gjykatë (*shih vendimet nr. 43, datë 27.12.2022; nr. 22, datë 22.9.2022; nr. 8, datë 23.2.2021, të Gjykatës Kushtetuese*).

18. E drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të janë të lidhura me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. E drejta për t'u njoftuar për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 22 datë 29.9.2022; nr. 8, datë 23.2.2021; nr. 49, datë 22.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

19. Gjykata vëren se kërkesat kushtetuese të procesit të rregullt ligjor janë reflektuar në përmbajtje të nenit 61 të ligjit nr. 49/2012, "Për gjykatat administrative dhe gjykimin e

mosmarrëveshjeve administrative", të ndryshuar (*ligji nr. 49/2012*), sipas të cilit shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë, si rregull, bëhet mbi bazë të dokumenteve, në dhomën e këshillimit (*pika 1*). Gjyqtari relator cakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, duke urdhëruar njoftimin e palëve. Sekretaria e gjykatës njofton, me shpallje, ditën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, si dhe përbërjen e trupit gjykues, të paktën 15 ditë përpara (*pika 2*). Në shtesë të këtyre rregullave, neni 482, pika 3, i Kodit të Procedurës Civile (*KPC*), i zbatueshëm për gjykimin administrativ, parashikon se njoftimi me shpallje bëhet edhe në faqen e internetit të Gjykatës së Lartë. Krahas njoftimit me shpallje, kjo dispozitë parashikon edhe njoftimin individual kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykimit. Këto rregulla janë detajuar në urdhrin nr. 131, datë 2.7.2021, "Për publikimin e datave të gjykimeve dhe njoftimin e palëve" të nxjerrë nga zëvendëskryetari i Gjykatës së Lartë.

20. Për sa më sipër, Gjykata rrithekson se në çdo çështje të veçantë, duke pasur parasysh edhe të gjithë procedurën që mund të jetë ndjekur, ajo vlerëson nëse një kufizim ose shkelje gjatë kësaj procedure ka ndikuar drejtpërdrejt në zgjidhjen e çështjes dhe ia ka bërë palës të pamundur mbrojtjen dhe zhvillimin e procesit gjyqësor në mënyrë të drejtë (*shih vendimet nr. 38, datë 2.12.2021; nr. 7, datë 28.2.2000, të Gjykatës Kushtetuese*).

21. Në rastin konkret, referuar akteve të ardhura me dosjen gjyqësore të administruar për qëllime të këtij gjykimi kushtetues, rezulton se rekursi i paraqitur nga subjekti i interesuar në procesin gjyqësor të kundërshtuar nga kërkuesi është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 20.3.2018, ndërsa shqyrtimi i çështjes në dhomën e këshillimit është caktuar të zhvillohet në datën 12.5.2022. Gjithashtu, rezulton se në datën 26.4.2022, në ambientet e Gjykatës së Lartë është shpallur shqyrtimi i çështjeve në dhomën e këshillimit për datën 12.5.2022, ku përfshihej edhe çështja e kërkuesit, si dhe përbërja e trupit gjykues. Ndërsa, referuar faqes zyrtare të Gjykatës së Lartë, për gjykimet që do të zhvilloheshin në datën 12.5.2022, nuk rezulton të jetë shpallur çështja e kërkuesit. Gjithashtu, po sipas faqes zyrtare të kësaj gjykate, rezulton se në datën 12.5.2022 ajo ka komunikuar



dispozitivët e vendimeve të marra në atë datë dhe për çështjen e kërkuarit lajmërohej se gjykimi ishte shtyrë për një datë tjetër.

22. Lajmërimi për shtyrjen e seancës rezultoi edhe nga procesverbali i datës 12.5.2022, ku Kolegji Administrativ, pasi ka verifikuar marrjen e dijeni për datën e shqyrtimit të çështjes nëpërmjet shpalljes publike, si dhe nëse ka kërkesa procedurale për përbërjen e trupit gjykues, ka vendosur të marrë në shqyrtim nëse rekursi përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 58 të ligjit nr. 49/2012 dhe pasi është tërhequr për të marrë vendim, ka vendosur ta marrë atë në një datë tjetër. Vendimi për çështjen e kërkuarit, objekt i këtij gjykimi kushtetues, është marrë në datën 13.5.2022

23. Për sa më lart, duke pasur parasysh rrethanat e rastit konkret, si dhe faktin se e drejta për t'u njoftuar e për të marrë pjesë në gjykim u paraprin të drejtave të tjera, Gjykata çmon të theksojë se Gjykata e Lartë duhet të tregojë kujdes të shtuar dhe duhet të zbatojë dispozitat ligjore në atë mënyrë që t'i garantojë individit garancitë kushtetuese të parashikuara në nenin 42 të Kushtetutës, ku përfshihet edhe e drejta për t'u njoftuar për datën dhe orën e seancës, sipas përcaktimeve të nenit 482 të KPC-së.

24. Gjithsesi, duke i rikthyer çështjes konkrete, rezultoi se sipas dëftesës së komunikimit të datës 16.2.2018, kërkuari është njoftuar për rekursin e paraqitur nga subjekti i interesuar, shkaqet e të cilit mund t'i kundërshtonte me kundërrekurs, sipas përcaktimeve të nenit 59 të ligjit nr. 49/2012 dhe nenit 472 të KPC-së, duke ushtruar në këtë mënyrë të drejtën e mbrojtjes. Gjithashtu, kërkuari nuk ka kundërshtuar as vendimin nr. 211, datë 17.4.2018, të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur pezullimin e vendimit nr. 6161, datë 3.12.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Në këtë kuptim, Gjykata çmon se mosshpallja nga Gjykata e Lartë e datës, orës dhe përbërjes së trupit gjykues në faqen e saj të internetit, sipas përcaktimit të nenit 482, pika 3, të KPC-së, nuk përbën shkelje të tillë, ku si pasojë kërkuarit i është cenuar e drejta substanciale e mbrojtjes, për të cilën ai nuk ka sjellë asnjë argument ose provë për të vërtetuar se në ç'mënyrë i është cenuar ajo. Gjykata e Lartë, nëpërmjet shpalljes në ambientet e saj të datës, orës dhe përbërjes së trupit gjykues, sipas përcaktimit të nenit 61 të ligjit nr. 49/2012, e ka kryer detyrimin

saj për garantimin e zhvillimit të një procesi të rregullt në respektim të elementeve të tij. Gjithashtu, kërkuari nuk ka paraqitur asnjë argument ose provë që të tregojë se ka qenë në pamundësi për t'u paraqitur në ambientet e asaj gjykate për të kontrolluar njoftimin për zhvillimin e gjykimit, duke u privuar nga e vetmja mundësi për t'u njoftuar për datën dhe orën e zhvillimit të gjykimit.

25. Për këtë arsye, Gjykata çmon të ritheksojë përsëri qëndrimin e mbajtur edhe më parë prej saj, se jo çdo shkelje e rregullave procedurale e bën procesin të parregullt, në aspektin e shkeljes së të drejtave kushtetuese, dhe se ndikim të drejtpërdrejtë në një proces ligjor kanë ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të individit (*shih vendimet nr. 38, datë 2.12.2021; nr. 71, datë 13.11.2017; nr. 30, datë 19.5.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

26. Për sa më sipër, pretendimi i kërkuarit për cenimin e parimit të kontradiktoritetit dhe së drejtës për t'u dëgjuar është i pabazuar.

B.2. Për cenimin e standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor lidhur me mbrojtjen efektive

27. Kërkuari pretendon se vendimi i Gjykatës së Lartë është alogjik, i paarsyetuar dhe i njëanshëm. Sipas tij, në raste të ngjashme, Gjykata e Lartë ka vendosur mospranimin e rekursit të bërë nga Bashkia Tiranë, ndërsa për rastin konkret ka ndryshuar vendimet e dy gjykatave më të ulëta, duke rrëzuar padinë dhe ndryshuar arsyetimin e vendimeve të saj. Gjykata e Lartë në arsyetim referon si shkak për ndryshimin e vendimeve të gjykatave natyrën e pozicionit të kërkuarit. Sipas këtij shkak, çështja duhet të kthehet për rigjykim që të rregullohet pikërisht ky moment ligjor material dhe procedural. Por, në kundërshtim me këtë arsyetim, Gjykata e Lartë ka ndryshuar vendimet e gjykatave më të ulëta dhe ka rrëzuar padinë.

28. Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore si garanci për të drejtën e procesit të rregullt ligjor. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit, përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Gjykata ka theksuar se vendimi gjyqësor, në çdo rast, duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët



përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre dhe ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë, dhe duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie ose kontradiksion të hapur ose të fshehtë (*shih vendimet nr. 11, datë 24.5.2022; nr. 16, datë 16.3.2021; nr. 12, datë 19.3.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

29. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata, rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsyetimin e vendimeve të tyre. Gjykata verifikon nëse arsyetimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 12, datë 19.3.2015, të Gjykatës Kushtetuese*).

30. Gjithashtu, Gjykata ka vënë në dukje rëndësinë kushtetuese që ka zbatimi dhe interpretimi i dispozitave ligjore nga gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përfshirë Gjykatën e Lartë, me qëllim që individit t'i garantohet procesi i rregullt në aspektet e aksesit në gjykatë dhe të mbrojtjes efektive (*shih vendimet nr. 7, datë 21.2.2023; nr. 40, datë 22.12.2022, të Gjykatës Kushtetuese*). Ndonëse interpretimi dhe zbatimi i ligjit, si dhe vlerësimi i fakteve dhe rrethanave, janë çështje që ndajnë juridiksionin e gjykatave të zakonshme nga juridiksioni kushtetues, Gjykata ndërhyr në ato raste kur gjykatat e juridiksionit të zakonshëm, përmes interpretimit dhe zbatimit të ligjit në një çështje konkrete, kanë cenuar të drejtat kushtetuese të palëve. Në këto raste, Gjykata bën një vlerësim të natyrës kushtetuese, të dallueshëm nga ai i gjykatave të juridiksionit të zakonshëm (*shih vendimet nr. 7, datë 21.2.2023; nr. 2, datë 17.2.2022; nr. 3, datë 23.2.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

31. Duke iu rikthyer rastit konkret, Gjykata vëren se kërkuessit i është njohur e drejta për dëmshpërblim me 19 paga mujore nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe Gjykata Administrative e Apelit. Sipas vendimeve të këtyre të fundit marrëdhënia juridike rregullohet nga Kodi i Punës dhe se subjekti i interesuar, Bashkia Tiranë, e ka zgjedhur kontratën në mënyrë të menjëhershme dhe pa respektuar afatet e njoftimit të parashikuara nga Kodi i Punës, ndërsa

Gjykata e Lartë ka vendosur ndryshimin e këtyre vendimeve dhe rrëzimin e kërkesëpadisë. Kjo e fundit ka arsyetuar se marrëdhënia juridike, mbi të cilën ka lindur mosmarrëveshja, rregullohet nga ligjet nr. 8652, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” (*ligji nr. 8652/2000*) dhe nr. 8654, datë 31.7.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Tiranë” (*ligji nr. 8654/2000*) (*shih paragrafin 17 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Sipas Gjykatës së Lartë, funksioni i nënkryetarit të njësisë bashkiake nuk përfshihet as në kategorinë e nëpunësve civilë, as në atë të punonjësve administrativë dhe për të përcaktuar natyrën e marrëdhënies së punës së këtij pozicioni, nevojitet analizimi i kompetencave dhe detyrave me të cilat ligji e ngarkon nënkryetarin e njësisë bashkiake, si një zëvendës i drejtpërdrejtë i kryetarit të njësisë bashkiake në përmbushjen e misionit për të cilin ky i fundit është zgjedhur drejtpërdrejt nga populli (*shih paragrafin 19 të vendimit të Gjykatës së Lartë*).

32. Gjykata vëren se kërkesëpadia e kërkuessit është rrëzuar nga Gjykata e Lartë për shkak se kjo e fundit ka vlerësuar se në bazë të dispozitave të ligjeve nr. 8652/2000 dhe nr. 8654/2000, natyra e funksionit publik të ushtruar nga kërkuessi tregon qartë se pozicioni i zëvendëskryetarit të bashkisë ose njësisë bashkiake mbështet drejtpërdrejt funksionin politik të kryetarit të bashkisë ose kryetarit të njësisë bashkiake. Duke vijuar më tej në arsyetimin e saj, Gjykata e Lartë ka vlerësuar se zëvendëskryetari i bashkisë/njësisë bashkiake është funksionar publik që ushtron funksione me natyrë politike. Prandaj, në logjikën juridike të qenies me natyrë politike edhe të këtij funksioni, ndryshe nga nëpunësit dhe punonjësit e tjerë administrativë të bashkisë/njësisë bashkiake, emërohet dhe shkarkohet nga kryetari i bashkisë/njësisë bashkiake (*shih paragrafin 21 të vendimit të Gjykatës së Lartë*). Për sa më sipër, duket qartë se vlerësimi që u është bërë dispozitave të ligjeve të sipërcituara nga Gjykata e Lartë, përbën çështje me natyrë ligjore.

33. Në këtë drejtim, Gjykata ka evidentuar se në procedurën e shqyrtimit të rekursit nga Gjykata e Lartë, ligjvënësi ka parashikuar disa kërkesa specifike në nenin 473/a, paragrafi 2, të KPC-së, i cili është i zbatueshëm në gjykimin administrativ, bazuar në nenin 1, pika 2, të ligjit nr. 49/2012. Sipas këtyre dispozitave, kur Gjykata e Lartë vë në diskutim çështje të ligjit, të cilat merren në shqyrtim



kryesisht dhe për të cilat palët nuk kanë paraqitur më parë mendimin e tyre, përpara shqyrtimit të rekursit urdhërohet njoftimi i palëve dhe caktohet afati për depozitim të parashtrësive të tyre për çështjet e ligjit. Në këto raste, neni 482/a, pika 1, shkronja “b”, i po këtij kodit, në harmoni me nenin 62, pika 1, shkronja “c”, të ligjit nr. 49/2012, parashikon se Gjykata e Lartë, nëse e vlerëson të nevojshme për shkak të problematikës ose kompleksitetit të çështjes, vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve (*shih vendimin nr. 7, datë 21.2.2023, të Gjykatës Kushtetuese*).

34. Për sa më sipër, duke iu referuar akteve në dosjen gjyqësore, Gjykata konstaton se në çështjen e kërkuarit referimi në dispozitat e ligjeve nr. 8652/2000 dhe nr. 8654/2000 nuk është paraqitur si shkak në rekursin e shqyrtuar në Gjykatën e Lartë. Kjo e fundit, duke u shprehur për shkaqe të tjera nga ato të paraqitura në rekurs, ka ndryshuar edhe shkakun e largimit nga puna. Referimi i Gjykatës së Lartë në dispozitat e ligjeve nr. 8652/2000 dhe nr. 8654/2000, dhe arsyetimi për to, është verifikuar si çështje ligjore për herë të parë dhe me nismë të vetë asaj në procedurën e shqyrtimit të rekursit në dhomën e këshillimit. Në këtë mënyrë, kërkuarit nuk i është dhënë mundësia të paraqesë paraprakisht mendimin e tij për çështjet ligjore të analizuar nga Gjykata e Lartë kryesisht. Ai është vendosur në pamundësi për t’u mbrojtur efektivisht për to, duke u përballur me një vendim gjyqësor të paplotë, alogjik dhe që nuk i jepte përgjigje përfundimtare pretendimeve që ai kishte për të drejtën e dëmshpërblimit si pasojë e ndërprerjes së menjëhershme të marrëdhënieve të punës. Për rrjedhojë, pretendimi i tij për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor lidhur me mbrojtjen efektive është i bazuar dhe vendimi i Gjykatës së Lartë duhet shfuqizuar.

35. Gjykata, duke mbajtur në konsideratë se në zbatim të parimit të *subsidiaritetit* kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese është funksion edhe i Gjykatës së Lartë, çmon të mos ndalet në analizimin e pretendimit tjetër të kërkuarit, që ka të bëjë me gjykimin nga një gjykatë e caktuar me ligj, për shkak se në çështjen konkrete ajo ka mbajtur një qëndrim të ndryshëm nga ai i mbajtur më parë për çështje të ngjashme. Për sa kohë që çështja do të merret sërish në shqyrtim nga

Gjykata e Lartë, kjo e fundit duhet t’i japë këtij pretendimi përgjigje të arsyetuar.

36. Në përfundim, Gjykata vlerëson se ankimi kushtetues i kërkuarit, sipas arsyetimit të mësipërm, është i bazuar, ndaj duhet pranuar.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pika 1, shkronja “i”, të Kushtetutës, si dhe neneve 72 e vijues të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, njëzëri,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.

2. Shfuqizimin e vendimit nr. 00-2022-1082 (189), datë 13.5.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

3. Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Kolegjin Administrativ të Gjykatës së Lartë.

Ky vendim është përfundimtar dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Marrë më 21.3.2023.

Shpallur më 20.4.2023.

Kryetare: Holta Zaçaj

Anëtarë: Fiona Papajorgji, Marsida Xhaferllari, Ilir Toska, Sandër Beci, Elsa Toska, Sonila Bejtja, Marjana Semini, Genti Ibrahim

MENDIM PARALEL

1. Në gjykimin kushtetues të çështjes që i përket kërkuarit Eduard Kelmendi, me objekt: “*Shfuqizimi i vendimit nr. 00-2022-1082 (189), datë 13.5.2022, të Kolegjit Administrativ të Gjykatës së Lartë, si i papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë*”, ne, gjyqtarët Fiona Papajorgji, Sandër Beci dhe Marsida Xhaferllari, ndajmë mendim të ndryshëm me shumicën, pasi vlerësojmë se kërkesa duhet të ishte pranuar për të dyja pretendimet e ngritura. Në mbështetje të nenit 132, pika 3, të Kushtetutës dhe nenit 72, pika 8, të ligjit nr. 8577/2000,



parashtrajtje në vijim argumentet që mbështesin qëndrimin tonë paralel.

2. Në mënyrë të përmbledhur, nga rrethanat e çështjes rezulton se padia e ngritur nga kërkuesi me objekt detyrimin e Bashkisë Tiranë ta dëmshpërblejë atë, për shkak të mosrespektimit të afatit të njoftimit të parashikuar në Kodin e Punës, është pranuar nga Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë dhe ky vendim është lënë në fuqi nga Gjykata Administrative e Apelit. Rekursi i ushtruar nga Bashkia Tiranë është regjistruar në Gjykatën e Lartë në datën 20.3.2018. Me vendimin e datës 27.4.2022, relatori i çështjes ka caktuar datën 12.5.2022 për shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, por pa përcaktuar orarin e zhvillimit të saj, si dhe ka urdhëruar sekretarinë e gjykatës të kryejë njoftimin e palëve për orën dhe datën e caktuar. Njoftimi për orën, datën dhe trupin gjykues është shpallur i afishuar vetëm në ambientet fizike të asaj gjykate, ndërkohë që nuk është shpallur në faqen elektronike të saj. Në procesverbalet e shqyrtimit të çështjes në dhomën e këshillimit, që mbajnë datat 12.5.2022, ora 15:20 dhe 13.5.2022, ora 10:20, është shënuar se palët ndërgjyqëse kanë marrë dijeni rregullisht sipas ligjit nëpërmjet shpalljes së datës 26.4.2022 dhe nuk rezulton të kenë paraqitur ndonjë kërkesë procedurale për përjashtimin e trupit gjykues, ndërsa kërkuesi nuk rezulton të ketë paraqitur kundërrekurs ose parashtrime me shkrim ndaj pretendimeve në recurs të palës tjetër. Në përfundim të shqyrtimit të çështjes, trupi gjykues në datën 12.5.2022 është tërhequr për marrjen e vendimit, të cilin e ka shtyrë për një datë tjetër, dhe në datën 13.5.2022 ka vendosur ndryshimin e vendimeve të gjykatave më të ulëta, si dhe rrëzimin e padisë së kërkuesit.

3. Shumica ka vlerësuar se pretendimet e kërkuesit për cenimin e parimit të kontradiktoritetit dhe së drejtës për t'u dëgjuar janë të pabazuara. Sipas saj, mangësia e konstatuar për sa i përket njoftimit të palëve me shpallje në faqen elektronike, në kontekst të rastit konkret, nuk përbën shkelje të tillë, ku si pasojë kërkuesit i është cenuar e drejta substanciale e mbrojtjes, pasi njoftimi ishte afishuar nga Gjykata e Lartë në këndin e njoftimeve në ambientet fizike të saj dhe kërkuesi, ndonëse është njoftuar rregullisht për rekursin, ka zgjedhur të mos paraqesë kundërrekurs për mbrojtjen eventuale të çështjes së tij; kërkuesi nuk ka paraqitur asnjë

argument ose provë që të tregojë se ka qenë në pamundësi për t'u paraqitur në ambientet e asaj gjykate për të kontrolluar njoftimin për zhvillimin e gjykimit, duke u privuar nga e vetmja mundësi për t'u njoftuar për datën dhe orën e zhvillimit të gjykimit (*shih paragrafin 24 të vendimit*).

4. Në ndryshim nga shumica çmojmë se pretendimi i kërkuesit për cenimin e parimit të kontradiktoritetit dhe së drejtës për t'u dëgjuar, për shkak të parregullsive të njoftimit për kohën e gjykimit dhe përbërjen e trupit gjykues, është i bazuar. Në nxjerrjen e këtij përfundimi vlejné të evidentohen tri arsye kryesore.

5. *Së pari*, Gjykata ka theksuar se e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të janë të lidhura me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshëm të individit. Nga njëra anë, kjo e drejtë u paraprin të drejtave të tjera, pasi nëse pala ndërgjyqëse nuk njoftohet për datën dhe orën e seancës, ajo detyrimisht do të gjendet në pamundësi objektive për të ushtruar të drejtat që i garantohen nga neni 42 i Kushtetutës në kuadrin e një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër, e drejta për të marrë pjesë në gjykim krijon të njëjtat mundësi për të paraqitur prova dhe argumente në mbrojtje të interesave vetjakë në raport me palën kundërshtare (*shih vendimet nr. 13, datë 20.2.2017; nr. 21, datë 4.4.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Gjykata ka një jurisprudencë të konsoliduar për mbrojtjen e garancive të procesit të rregullt në drejtim të njoftimit dhe pjesëmarrjes në proces të palëve ndërgjyqëse, duke verifikuar për këtë qëllim rregullsinë e procedurave të njoftimit të ndjekura nga Gjykata e Lartë. Në një numër të konsiderueshëm rastesh të ankimeve kushtetuese individuale, që kanë pasur në objektin e tyre këtë pretendim, Gjykata, pavarësisht nëse çështja është shqyrtuar në seancë publike ose mbi bazë dokumentesh, ka verifikuar nga pikëpamja faktike nëse njoftimi është realizuar në mënyrat e domosdoshme të përcaktuara nga ligji – me anë të shpalljes në ambientet fizike dhe shpalljes në faqen elektronike. Kur është konstatuar se njoftimi për datën e zhvillimit të seancës në Gjykatën e Lartë nuk ka qenë i shpallur në faqen elektronike të saj, Gjykata e ka pranuar pretendimin për cenimin e procesit të rregullt ligjor, duke argumentuar se sekretaria e Gjykatës së Lartë ka detyrimin për njoftimin e rregullt të palëve, në mënyrë që ato të



mund të marrin pjesë në gjykim, si dhe të dëgjoen, qoftë edhe mbi bazën e dokumenteve, me anë të paraqitjes së komenteve ose prapësimeve, me qëllim garantimin e së drejtës së mbrojtjes, barazisë së armëve në gjykim dhe kontradiktoritetit (*shih vendimet nr. 20, datë 22.9.2022; nr. 17, datë 1.3.2017; nr. 13, datë 20.2.2017; nr. 76, datë 16.12.2016; nr. 49, datë 22.7.2016, të Gjykatës Kushtetuese*). Ky konstatim ka qenë i mjaftueshëm për Gjykatën për të pranuar kërkesën dhe për të kthyer çështjen për rishqyrtim pranë Gjykatës së Lartë. Madje, Gjykata ka pohuar se njoftimi i datës dhe orës së gjykimit është një akt i domosdoshëm procedural, që merr rëndësi më tepër në rastin kur Gjykata e Lartë ka ndryshuar dy vendimet e gjykatave më të ulëta dhe ka rrëzuar padinë e kërkuarit. Në këtë rast, moskomunikimi i zhvillimit të seancës nga ana e administratës gjyqësore, në përputhje me rregullat procedurale për zhvillimin e gjykimit administrativ, sjell mospërfitimin e garancive ligjore të kërkuarit për njohjen në kohë të pretendimeve të palës tjetër dhe kundërshtimin e tyre nëpërmjet paraqitjes së argumenteve, kjo me qëllim shmangien e vënies në një pozitë të pafavorshme në raport me atë palë (*shih vendimin nr. 65, datë 7.11.2016, të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Mbi bazën e kësaj jurisprudence, nuk pajtohem me argumentin e shumicës, që ka shërbyer për rrëzimin e pretendimit për cenimin e së drejtës së njoftimit, sipas të cilit ndonëse kërkuari është njoftuar rregullisht për rekursin, ka zgjedhur të mos paraqesë kundërrkurs dhe se në rrjedhën e procesit gjyqësor ai ka pasur mundësinë dhe ka arritur të realizojë mbrojtjen e interesave të veta. Në këtë pikë duhet evidentuar se vendimmarrja e gjykatave të dy shkallëve të para të gjykimit ka vendosur në favor të kërkuarit, ndërsa vendimmarrja e Gjykatës së Lartë e ka përmbysur këtë rezultat, duke e rrëzuar padinë e ngritur prej tij në gjykatat e juridiksionit të zakonshëm.

8. *Së dyti*, rëndësia e njoftimit të palëve për zhvillimin e gjykimit, përfshirë atë të Gjykatës së Lartë, dhe forcimi i garancive për realizimin e njoftimit efektiv janë përkrahur edhe nga zhvillimet e fundit legjislativë dhe praktika e punës së gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Ato u janë përgjigjur zhvillimeve të teknologjisë së informacionit, që kanë lehtësuar komunikimin në jetën e përditshme, pavarësisht distancave gjeografike. Kështu, fillimisht, në vitin 2012, ligji

për organizimin e gjykatave administrative e, më tej, ndryshimet në KPC, në vitin 2017, kanë parashikuar përdorimin e mjeteve elektronike gjatë procesit, ku krahas njoftimit me shpallje në ambientet fizike realizohet edhe njoftimi në faqen elektronike të gjykatës, si edhe njoftimi individual i drejtpërdrejtë, në rastin kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit. Në të njëjtën linjë, Gjykata e Lartë, me urdhrin e datës 2.7.2021, ka përcaktuar detyrimin e sekretarisë gjyqësore që përveç afishimit në këndin e njoftimit dhe shpalljes në faqen elektronike, të kryejë edhe njoftimin elektronik në adresat e postës elektronike të palëve.

9. Në këtë kontekst, ne ndajmë vlerësim të ndryshëm me shumicën, sipas së cilës mungesa e njoftimit në faqen elektronike nuk përbën shkelje thelbësore, pasi çmojmë se ky argument dobëson garancitë e individit dhe nuk i përgjigjet zhvillimit aktual shoqëror. Në këtë drejtim, sjellim në vëmendje se evoluimi i mënyrave të veprimit, edhe nëpërmjet përdorimit të mjeteve elektronike, paraqet rëndësi për të lehtësuar dhe siguruar jo vetëm efektivitetin e këtyre veprimeve, por edhe përmbushjen e pritshmërive të qytetarëve. Përdorimi i këtyre mjeteve është i nevojshëm në procedurat gjyqësore, pasi pavarësisht distancave fizike të selive të gjykatave dhe vendbanimeve të palëve ndërgjyqëse, krijon mundësi komunikimi dhe aksesit në kohë reale dhe të garantuar.

10. *Së treti*, nisur nga rrethanat e çështjes konkrete, vlerësojmë se kriteri i përdorur nga shumica, sipas të cilit kërkuari ngarkohet me barrën për të paraqitur një “argumente ose prova që të tregojë se ka qenë në pamundësi për t’u paraqitur në ambientet e asaj gjykate për të kontrolluar njoftimin për zhvillimin e gjykimit, duke u privuar nga e vetmja mundësi për t’u njoftuar për datën dhe orën e zhvillimit të gjykimit”, së bashku me faktin se rekursi është marrë në shqyrtim pas më shumë se 4 vjetësh nga regjistrimi i tij, nga njëra anë, krijon një barrë joproportionale mbi individin, që ia vështirëson gjer në mohim të drejtën e aksesit në gjykim. Ndërkohë që, nga ana tjetër, ky kriter krijon konflikt juridiksioni, pasi e vendos Gjykatën në pozicionin për të vlerësuar bazueshmërinë e themelit të shkaqeve të rekursit, që është pjesë e juridiksionit të Gjykatës së Lartë.

11. Nën këtë analizë, vlerësojmë se Gjykata e Lartë, duke e realizuar njoftimin vetëm me shpallje në ambientet fizike, nuk ka përmbushur detyrimin



ligjor për njoftimin edhe në faqen elektronike të saj. Mënyra se si Gjykata e Lartë ka vepruar, në dukje të krijon idenë sikur ka vendosur dhe përmbysur rezultatit e çështjes në disfavor të kërkuarit, vetëm mbi bazën e pretendimeve të parashtruara në rekurs nga pala tjetër, duke mos i dhënë mundësinë kërkuarit të dëgjohej dhe të mbrohej me shkrim në lidhje me çështjen. Për më tepër, barra e vendosur ndaj kërkuarit është dukshëm joproportionale, pasi shqyrtimi i rekursit është bërë pas një kohe relativisht të gjatë dhe pritshmëritë që ai të paraqitej vijimisht gjatë 4 vjetëve pranë ambienteve fizike të Gjykatës së Lartë, edhe pse banon në qytetin e Tiranës, janë haptazi të paarsyshme. Në këto kushte, Gjykata e Lartë ka dështuar në garantimin e procesit të rregullt gjyqësor, pasi e ka vendosur kërkuarin në pamundësi për të paraqitur pretendimet e tij, i cili jo vetëm potencialisht, por edhe faktikisht është prekur nga vendimmarrja e saj, duke u vendosur në pozita të pafavorshme.

12. Në përfundim, ne, gjyqtarët me mendim paralel, vlerësojmë se pretendimet e kërkuarit për cenimin e parimit të kontradiktoritetit dhe së drejtës për t'u dëgjuar janë të bazuara, për rrjedhojë ankimi kushtetues i tij duhet të pranohej plotësisht.

Anëtarë: Marsida Xhaferllari, Sandër Beci, Fiona Papajorgji

VENDIM

Nr. 70, datë 30.3.2023

PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE ARSYEVE TË LEJIMIT TË KANDIDATIT PËR MAGJISTRAT PËR T’U EMËRUAR NË VITIN PASARDHËS”

Bazuar në nenin 189, pika 1, germa “c”, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, nenin 35, pika 5, dhe nenin 174, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozim të grupit të punës të ngritur me urdhrin nr. 188, datë 30.12.2022, “Për ngritjen e grupit të punës për hartimin e rregullores për Përcaktimin e rregullave dhe arsyeve të lejimit të kandidatit për magistrat për t’u emëruar në vitin pasardhës”, të ndryshuar, Këshilli i Lartë i Prokurorisë

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për përcaktimin e rregullave dhe arsyeve të lejimit të kandidatit për magistrat për t’u emëruar në vitin pasardhës”, sipas tekstit të bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Kjo rregullore hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare *web* të Këshillit.

3. U shpall në Tiranë, më 30.3.2023.

**KRYETAR
Alfred Balla**

RREGULLORE

PËR PËRCAKTIMIN E RREGULLAVE DHE ARSYEVE TË LEJIMIT TË KANDIDATIT PËR MAGJISTRAT PËR T’U EMËRUAR NË VITIN PASARDHËS

**Neni 1
Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave dhe i arsyeve të lejimit të kandidatit për magistrat për t’u emëruar në vitin pasardhës.

**Neni 2
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të sigurojë, që gjatë procedurës së lejimit të kandidatit për magistrat për t’u emëruar në vitin pasardhës, të garantohet interesi më i lartë i sistemit të prokurorisë, si dhe interesi publik.

**Neni 3
Fusha e zbatimit**

Dispozitat e kësaj rregulloreje zbatohen nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si dhe nga çdo i diplomuar që kërkon të emërohet në vitin pasardhës.

**Neni 4
Përkufizime**

Për qëllime të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:



a) **“Këshill”** nënkupton Këshillin e Lartë të Prokurorisë, i cili është organi që merret me çështje që lidhen me prokurorët, të emëruarit, të diplomuarit dhe kandidatët për magistratë që ndjekin Shkollën e Magistraturës, me qëllim që të bëhen prokurorë;

b) **“I diplomuar”** nënkupton personin, i cili është përfshirë në listën e renditjes së të diplomuarve nga Shkolla e Magistraturës, por nuk është emëruar ende si magistrat;

c) **“I emëruar”** nënkupton personin, i cili është diplomuar nga Shkolla e Magistraturës dhe është emëruar magistrat nga Këshilli, por nuk është caktuar ende në pozicion;

d) **“Ditë”** nënkupton ditët kalendarike, me përjashtim të afateve nën 10 ditë, të cilat llogariten me ditë pune;

e) **“Raport mjekësor”** nënkupton dokumentin që i siguruari duhet të paraqesë për t’u njohur paaftësia e përkohshme në punë, i cili lëshohet nga mjekët e institucioneve shëndetësore shtetërore, si dhe nga mjekët dhe institucionet shëndetësore private, që kanë kontratë me Institutin e Sigurimeve Shoqërore, bazuar në rregulloren nr. 494, datë 5.10.1993, “Për lëshimin e raporteve për paaftësi të përkohshme në punë”.

f) **“Komisioni Mjekësor Shqiptar”** nënkupton Komisionin Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë (KMCA);

g) **“Birësim”** nënkupton procedurën administrative dhe gjyqësore, nëpërmjet së cilës fëmijës së porsalindur deri në 1 vjeç, që i ishte privuar ose jo mjedisi familjar, i sigurohet një familje alternative, me të drejta dhe detyrime të njëjta me prindërit biologjikë.

Neni 5

Kushtet ligjore për lejimin e të diplomuarit për t’u emëruar në vitin pasardhës

1. Kërkesa për emërimin si magistrat në vitin pasardhës mund të bëhet për rastet e mëposhtme:

a) Për arsye shëndetësore të tij, të bashkëshortit / bashkëjetuesit, paralindurve dhe paslindurve të drejtpërdrejtë të tij nën përkujdesjen e vazhdueshme të kërkuesit që shkaktojnë pamundësi të përkohshme për të ushtruar detyrën e prokurorit, të vërtetuar me dokument të lëshuar nga institucioni shëndetësor brenda vendit ose me dokument mjekësor zyrtar të lëshuar nga

institucioni jashtë vendit, të bashkëshoqëruar me urdhrin e Komisionit Mjekësor Shqiptar që ka lëshuar me prapaveprim raportin mjekësor;

b) Për shkak të shtatzënisë, lindjes së fëmijës, të birësimit të një fëmije të porsalindur deri në 1 vjeç, të vërtetuar me dokumente përkatëse;

c) Për shkak të çdo interesi tjetër të ligjshëm, në rastet e masave të jashtëzakonshme, si dhe në rast nevojë e urgjence, për një periudhë deri në 12 muaj, të vërtetuar me dokumente përkatëse.

Neni 6

Kërkesa e të diplomuarit

I diplomuari që plotëson kriteret ligjore të ligjit për statusin mund të paraqesë kërkesë me shkrim pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë për emërimin si magistrat në vitin pasardhës. Kërkesa paraqitet jo më vonë se dy javë nga data e publikimit të listës nga Shkolla e Magistraturës.

Neni 7

Vendimmarrja e Këshillit të Lartë të Prokurorisë

1. Këshilli i Lartë i Prokurorisë shqyrton kërkesën e të diplomuarit për t’u emëruar në vitin pasardhës, brenda afatit një mujor nga data e publikimit të listës së të diplomuarve nga Shkolla e Magistraturës, duke pranuar ose refuzuar kërkesën.

2. Kundër vendimit të refuzimit të kërkesës për t’u emëruar në vitin pasardhës bëhet ankim, së bashku me vendimin e emërimit si magistrat, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të emërimit, në Gjykatën Administrative të Apelit.

3. Në rast të pranimit të kërkesës për t’u emëruar në vitin pasardhës, gjatë kohëzgjatjes së kësaj periudhe i diplomuari nuk përfiton asnjë trajtim ekonomik në formë page, shpërblimi apo çdo të ardhure tjetër që lidhet me statusin e magistratit apo detyrën e prokurorit.

Neni 8

Rënia e shkakut të kërkesës së miratuar

Nëse pas miratimit të kërkesës nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë për t’u emëruar në vitin pasardhës bie shkak objekti i kërkesës, i diplomuari do të emërohet si magistrat në periudhë e emërimit të vitit pasardhës.



Neni 9

Caktimi në pozicioni i kërkuesit në vitin pasardhës

Caktimi në pozicioni i kërkuesit në vitin pasardhës, bazohet në renditjen e tij/saj në listën e të diplomuarve të vitit të tij akademik. Këshilli i Lartë i Prokurorisë për qëllim të këtij neni rendit të gjithë të diplomuarit e vitit aktual dhe paraardhës sipas pikëve të fituara nga Shkolla e Magjistraturës. Në rastet kur të dy të sapoemëruarit kanë pikë të barabarta, ka përparësi preferenca e të emëruarit në vitin aktual.

Neni 10

Verifikimi i figurës dhe i pasurisë për të diplomuar që do të emërohet në vitin pasardhës

Këshilli i Lartë i Prokurorisë për të diplomuarin që do të emërohet në vitin pasardhës, mban në konsideratë raportin e verifikimit të pasurisë dhe figurës të vitit paraardhës dhe vetëm në rastet e një dyshimi të arsyeshëm mund të rivefikojë të diplomuarin për periudhën midis diplomimit dhe emërimit.

Neni 11

Hyrja në fuqi

Ngarkohet Komisioni për Zhvillimin e Karrierës pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë për shqyrtimin e kërkesave administrative të të diplomuarve për t'u emëruar në vitin pasardhës.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Kjo rregullore hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe publikohet në faqen zyrtare *web* të Këshillit.

VENDIM

Nr. 347, datë 13.4.2023

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË “PARTISË SOCIALISTE TË SHQIPËRISË”, QARKU ELBASAN, Z. SHKËLQIM SHEFQET BULLARI

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n”, e 2, 163, pika 7, 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; dhe të kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 1073/1 prot., datë 27.3.2023, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar si pasojë e dorëheqjes nga mandati i deputetit, të z. Besion Gëzim Ajazi, i zgjedhur në zonën zgjedhore, qarku Elbasan, propozuar nga Partia Socialiste e Shqipërisë.

Partia Socialiste e Shqipërisë është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 69, datë 15.2.2021.

Komisioni Rregullator me vendimin nr. 21, datë 13.7.2021, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të zhvilluara në datë 25.4.2021.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, nëpërmjet vendimit nr. 416, datë 23.6.2021, miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues, si dhe rirenditjen e kandidatëve të cilët nuk kanë përfutur



mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese në zonën zgjedhore, qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25.4.2021.

Sipas këtij vendimi Partia Socialiste e Shqipërisë, për zonën zgjedhore, qarku Elbasan, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25 prill 2021, ka fituar 8 (tetë) mandate.

Rezultoni se lista shumëmemërore e Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, qarku Elbasan, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë.

Zëvendësimi i vakancës do të bëhet në mbështetje të nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor, si dhe vendimit nr. 416, datë 23.6.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve në të cilin është miratuar rirenditja e kandidatëve, të cilët nuk kanë përfituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese.

Sipas këtij vendimi, rezultoni se kandidati të cilit i kalon mandati i deputetit është kandidati me numër rendor 09 (nëntë), z. Shkëlqim Shefqet Bullari.

Me shkresën nr. 2228 prot., datë 29.3.2022, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidati për deputet, të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, qarku Elbasan, z. Shkëlqim Shefqet Bullari, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant.

Kandidati për deputet, z. Shkëlqim Shefqet Bullari, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me 16 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i deputetit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe kreut V, pika 2, shkronja “b”, dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, nëpërmjet komunikimit elektronik ka kërkuar informacion nga zyra e

gjendjes civile, si dhe nga zyra e gjendjes gjyqësore për z. Shkëlqim Shefqet Bullari, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Elbasan, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Shkëlqim Shefqet Bullari.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Elbasan, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Shkëlqim Shefqet Bullari, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Pas verifikimeve të kryera, referuar pikës 2, të kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Elbasan, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Shkëlqim Shefqet Bullari, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit z. Besion Gëzim Ajazi i përket kandidatit vijues në listën shumëmemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore Elbasan, i renditur me numër rendor 9 (nëntë), z. Shkëlqim Shefqet Bullari.

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163, pika 7, 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; dhe në kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”



VENDOS:

1. Dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë, në zonën zgjedhore, qarku Elbasan, z. Shkëlqim Shefqet Bullari.

2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tri) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONER SHTETËROR
I ZGJEDHJEVE
Ilirjan Celibashi

VENDIM
Nr. 348, datë 13.4.2023

**PËR DHËNIEN E MANDATIT TË
DEPUTETIT TË KUVENDIT TË
SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS
SHUMEMËRORE TË KOALICIONIT
“PARTIA DEMOKRATIKE–ALEANCA
PËR NDRYSHIM”, QARKU TIRANË,
Z. ASLLAN SHABAN DOGJANI**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163 pika 7, 164 pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; dhe të kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 1055/2 prot., datë 27.3.2023, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar, si pasojë e dorëheqjes nga

mandati i deputetit, të z. Belind Zamir Këllici, i zgjedhur në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, propozuar nga koalicioni “Partia Demokratike–Aleanca për Ndryshim”.

Koalicioni “Partia Demokratike–Aleanca për Ndryshim”, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, me vendimin e Komisionierit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 107, datë 2.3.2021.

Komisioni Rregullator me vendimin nr. 21, datë 13.7.2021, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë në datë 25.4.2021.

Komisionieri Shtetëror, nëpërmjet vendimit nr. 409, datë 23.6.2021, miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues, si dhe rirenditjen e kandidatëve të cilët nuk kanë përfituar mandate në bazë të numrit të votimeve parapëlqyese, qarku Tiranë, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25.4.2021.

Sipas këtij vendimi, Koalicioni “Partia Demokratike–Aleanca për Ndryshim”, për zonën zgjedhore, qarku Tiranë, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë.

Sipas këtij vendimi rezultojnë se, kandidatit të cilit i kalon mandati i deputetit, është kandidati me numër rendor 18 (tetëmbëdhjetë), z. Asllan Shaban Dogjani, i cili i përket Koalicionit Partia Demokratike–Aleanca për Ndryshim”.

Me shkresën nr. 2225 prot., datë 29.3.2023, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për deputet, të listës shumëmemërore të koalicionit “Partia Demokratike–Aleanca për Ndryshim”, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, z. Asllan Shaban Dogjani, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin, të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant.

Kandidati për deputet, z. Asllan Shaban Dogjani, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 14 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për



administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i deputetit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, nëpërmjet komunikimit elektronik ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile, si dhe nga zyra e gjendjes gjyqësore për z. Asllan Shaban Dogjani, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Asllan Shaban Dogjani.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Asllan Shaban Dogjani, ku konstatohet se kandidati, në bazë të vendimit nr. 317 datë 24.11.2004, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër ka deklaruar pushimin e gjyqësorit të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit akuzuar për veprën penale “Shpifjen dhe përhapjen e qëllimshme e thënies dhe të çdo informacioni që dihet se janë të rreme”. Gjykata e Apelit Shkodër, me vendimin nr. 97, datë 6.4.2005, ka vendosur lënien në fuqi të vendimit. Konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Pas verifikimeve të kryera, referuar pikës 2, të kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Asllan Shaban Dogjani, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit z. Belind Zamir Këlliçi, u përket kandidatit vijues në listën shumemërore të koalicionit “Partia Demokratike–Aleanca për Ndryshim”, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, i renditur me numër rendor 18 (tetëmbëdhjetë), z. Asllan Shaban Dogjani.

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n” e 2, 163 pika 7, 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe në kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”,

VENDOS:

1. Dhënien e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të koalicionit “Partia Demokratike–Aleanca për Ndryshim”, në zonën zgjedhore, qarku Tiranë, z. Asllan Shaban Dogjani.

2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONER SHTETËROR
I ZGJEDHJEVE
Ilirjan Celibashi

VENDIM
Nr. 349, datë 13.4.2023

**PËR DHËNIEN E MANDATIT TË
DEPUTETIT TË KUVENDIT TË
SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS
SHUMEMËRORE TË KOALICIONIT
“PARTIA DEMOKRATIKE - ALEANCA
PËR NDRYSHIM”, QARKU SHKODËR,
Z. LODOVIK STAK HASANI**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n”, e 2, 163, pika 7, 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; dhe të kreut V, të



vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 1075/1 prot., datë 27.3.2023, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar si pasojë e dorëheqjes nga mandati i deputetit, të z. Zef Kin Hila, i propozuar nga Partia Demokratike i zgjedhur në zonën zgjedhore, qarku Shkodër, propozuar nga koalicioni “Partia Demokratike-Aleanca për Ndryshim”.

Koalicioni “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim”, është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 107, datë 2.3.2021.

Komisioni Rregullator me vendimin nr. 21, datë 13.7.2021, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të zhvilluara në datë 25.4.2021.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet vendimit nr. 410, datë 23.6.2021 miratoi shpërndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues, si dhe rirënditjen e kandidatëve të cilët nuk kanë përfituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese në zonën zgjedhore, qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25.4.2021.

Sipas këtij vendimi koalicioni “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim” për zonën zgjedhore, qarku Shkodër, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, ka fituar 5 (pesë) mandate.

Rezulton se lista shumëmemërore e koalicionit “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim”, në zonën zgjedhore, qarku Shkodër, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë.

Zëvendësimi i vakancës do të bëhet në mbështetje të nenit 164, pika 2, të Kodit Zgjedhor,

si dhe vendimit nr. 410, datë 23.6.2021, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në të cilin është miratuar rirënditja e kandidatëve, të cilët nuk kanë përfituar mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese.

Sipas këtij vendimi, rezulton se kandidati të cilit i kalon mandati i deputetit është kandidati me numër rendor 07 (shtatë), z. Lodovik Stak Hasani, i cili i përket Partisë Republikane Shqiptare (PR), pjesë e koalicionit “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidati për deputet, të listës shumëmemërore të koalicionit “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim”, në zonën zgjedhore, qarku Shkodër, z. Lodovik Stak Hasani, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Referuar nenit 11 të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse për Kuvendin të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant.

Kandidati për deputet, z. Lodovik Stak Hasani, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 17 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i deputetit.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, nëpërmjet komunikimit elektronik ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile, si dhe nga zyra e gjendjes gjyqësore për z. Lodovik Stak Hasani, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë për verifikimin e të dhënave për kandidatin për deputet në zonën zgjedhore, qarku Shkodër për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Lodovik Stak Hasani.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë



në zonën zgjedhore, qarku Shkodër, z. Lodovik Stak Hasani, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.

Pas verifikimeve të kryera, referuar pikës 2, të kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatohet se të dhënat e kandidatit për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Shkodër, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Lodovik Stak Hasani, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit z. Zef Kin Hila, i përket kandidatit vijues në listën shumemërore të koalicionit “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim”, Partia Republikane Shqiptare (PR) në zonën zgjedhore qarku Shkodër, i renditur me numër rendor 07 (shtatë), z. Lodovik Stak Hasani.

PËR KËTO ARSYE,

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronjat “ÿ”, “n”, e 2, 163, pika 7, 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, dhe në kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

VENDOS:

1. Dhënie e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumemërore të koalicionit “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim”, Partia Republikane Shqiptare (PR) në zonën zgjedhore, qarku Shkodër, z. Lodovik Stak Hasani.

2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONER SHTETËROR
I ZGJEDHJEVE
Ilirjan Celibashi

VENDIM

Nr. 350, datë 13.4.2023

PËR DHËNIEN E MANDATIT TË DEPUTETIT TË KUVENDIT TË SHQIPËRISË, KANDIDATIT TË LISTËS SHUMEMËRORE TË KOALICIONIT “PARTIA DEMOKRATIKE - ALEANCA PËR NDRYSHIM”, PARTIA REPUBLIKANE SHQIPTARE (PR) (QARKU ELBASAN, Z. QANI REXHEP XHAFA

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronjat “ÿ”, “n”, e 2, 163, pika 7, 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; të nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; dhe të kreut V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 1052/2 prot., datë 27.3.2023, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, vakancë kjo e krijuar si pasojë e dorëheqjes nga mandati i deputetit, të z. Luçiano Dhimitër Boçi, i zgjedhur në zonën zgjedhore, qarku Elbasan, propozuar nga koalicioni “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim”.

Koalicioni “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim” është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve nr. 107, datë 2.3.2021

Komisioni Rregullator me vendimin nr. 21, datë 13.7.2021, shpalli rezultatin përfundimtar të zgjedhjeve për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të zhvilluara në datë 25.4.2021.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve nëpërmjet vendimit nr. 416, datë 23.6.2021, miratoi shpër-



ndarjen e mandateve midis subjekteve zgjedhore, përcaktimin e kandidatëve fitues, si dhe rirënditjen e kandidatëve të cilët nuk kanë përfitur mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese në zonën zgjedhore, qarku Elbasan, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25.4.2021.

Sipas këtij vendimi, koalicioni “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim” për zonën zgjedhore, qarku Elbasan, për zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25 Prill 2021, ka fituar 6 (gjashtë) mandate.

Rezulton se lista shumëmemërore e koalicionit “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim”, në zonën zgjedhore, qarku Elbasan, i plotëson të gjitha kriteret e përcaktuara në nenin 67 të Kodit Zgjedhor, duke përfshirë dhe kriterin e gjinisë.

Zëvendësimi i vakancës do të bëhet në mbështetje të nenit 164 pika 2, të Kodit Zgjedhor, si dhe vendimit nr. 416, datë 23.6.2021 të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, në të cilin është miratuar rirënditja e kandidatëve, të cilët nuk kanë përfitur mandat në bazë të numrit të votave parapëlqyese.

Sipas këtij vendimi, rezulton se kandidati të cilit i kalon mandati i deputetit është kandidati me numër rendor 07 (shtatë), z. Qani Rexhep Xhafa.

Me shkresën nr. 2226 prot., datë 29.3.203, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidati për deputet, të listës shumëmemërore të koalicionit “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim”, në zonën zgjedhore, qarku Elbasan, z. Qani Rexhep Xhafa, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumëmemërore për zgjedhjet pararendëse, për Kuvendin të cilit i takon të marrë mandatin e deputetit për vendin vakant.

Kandidati për deputet, z. Qani Rexhep Xhafa ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 15 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i deputetit.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, të kandidati për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Elbasan, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Qani Rexhep Xhafa, rezulton se ka deklaruar:

- Në rubrikën III “TË DHËNA MBI GJENDJEN GJYQËSORE TË PERSONIT”

Pyetjes 4, “A keni qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një veprë penale?”, subjekti vetëdeklarues i është përgjigjur “Po”, duke deklaruar, se: “Është ndaluar nga autoritetet për drejtim automjeti në mënyrë të parregullt”, më datë 11.3.2023, çështje për të cilën është nën hetim.

Pyetjes 5, “A është caktuar ndaj jush ndonjëherë masë shtrënguese e sigurisë personale, në fuqi ose jo?”, subjekti vetëdeklarues i është përgjigjur “Po”, duke deklaruar, se: “Është caktuar masa e detyrimit për t’u paraqitur në policinë gjyqësore”. Për drejtim automjeti në mënyrë të parregullt, më datë 11.3.2023, çështje për të cilën është nën hetim në vazhdim.

Pas verifikimeve të kryera, referuar pikës 2, të kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatoj, se të dhënat e kandidati për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Elbasan, për Kuvendin e Shqipërisë, z. Qani Rexhep Xhafa, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidati në funksionin e deputetit në Kuvendin e Shqipërisë.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 dhe kreut V, pika 2, shkronja “b”, dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, nëpërmjet komunikimit elektronik ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile, si dhe nga zyra e gjendjes gjyqësore për z. Qani Rexhep Xhafa, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë për verifikimin e të dhënave për kandidatin për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Elbasan, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Qani Rexhep Xhafa.

Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Elbasan, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Qani Rexhep Xhafa, ku konstatohet se kandidati nuk është i dënuar me vendim penal të formës së prerë.



Pas verifikimeve të kryera, referuar pikës 2, të kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit, konstatohet se të dhënat e kandidatit për deputet, në zonën zgjedhore, qarku Elbasan, për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë, z. Qani Rexhep Xhafa, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e deputetit në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë.

Për sa më sipër, mandati i ndërprerë i deputetit z. Luçiano Dhimitër Boçi, i përket kandidatit vijues në listën shumëmemërore të koalicionit “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim”, Partia Republikane Shqiptare (PR) në zonën zgjedhore, qarku Elbasan, i renditur me numër rendor 07 (shtatë), z. Qani Rexhep Xhafa.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronjat “i”, “n”, e 2, 163, pika 7, 164, pika 2, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar; në nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”; dhe në kreun V, të vendimit nr. 17/2016, të Kuvendit, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”;

VENDOS:

1. Dhënie e mandatit të deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, kandidatit të radhës në listën shumëmemërore të koalicionit “Partia Demokratike - Aleanca për Ndryshim”, Partia Republikane Shqiptare (PR) në zonën zgjedhore, qarku Elbasan, z. Qani Rexhep Xhafa.

2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KOMISIONER SHTETËROR
I ZGJEDHJEVE
Ilirjan Celibashi

KËRKESË

Nr. 220/9, datë 25.4.2023

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Agjencia Shtetërore për Shpronësim shpall kërkesën “Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit ‘Projekt i parkut ujqor Tushemisht–Drilon’”.

Subjekti kërkuar i këtij projekti është Bashkia Pogradec.

Me anë të këtij publikimi, kërkojmë të vëmë në dijeni personat e prekur nga ky shpronësim, për interes publik, për pasuritë e paluajtshme, pronë private, të cilat do të kompensohen sipas vlerësimit paraprak të llogaritur, për pasuritë e llojit “arë” bazuar në VKM-në nr. 89, datë 3.2.2016, “Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në Republikën e Shqipërisë”.

Personat që preken nga ky projekt të cilët kanë emrin në tabelën e publikuar dhe personat të cilët preken, por nuk figurojnë në listë, jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga publikimi në Fletoren Zyrtare kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të shoqëruara me dokumentacionin përkatës, si edhe të shprehin nëse janë dakord me të dhënat e publikuara për përfundimin e procedurave të shpronësimit, në Bashkinë Pogradec, si dhe në Agjencinë Shtetërore për Shpronësimin.

Vlera totale paraprake e shpronësimit është 5,244,934 (pesë milionë e dyqind e dyzet e katër mijë e nëntëqind e tridhjetë e katër) lekë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM
KRYETAR I KOMISIONIT TË POSAÇËM
TË SHPRONËSIMEVE
Egra Ibrahim



52	Shtet	Tushemisht	3664	259	Pa frutë	2000		3	243					366	83	0	0
54	Shtet	Tushemisht	3664	255	Pa frutë	7600		3	239						83	0	0
57										192	0	1640	0		83	0	0
58										192	0	1640	0		83	0	0
59										192	0	1640	0		83	0	0
60										192	0	1640	0		83	0	0
61										192	0	1640	0		83	0	0
62										192	0	1640	0		83	0	0
63										192	0	1640	0		83	0	0
64										192	0	1640	0		83	0	0
65										192	0	1640	0		83	0	0
66										192	0	1640	0		83	0	0
67										192	0	1640	0		83	0	0
68										192	0	1640	0		83	0	0
69										192	0	1640	0		83	0	0
70										192	0	1640	0		83	0	0
71										192	0	1640	0		83	0	0
72										192	0	1640	0		83	0	0
73										192	0	1640	0		83	0	0
74										192	0	1640	0		83	0	0
75										192	0	1640	0		83	0	0
76										192	0	1640	0		83	0	0
77										192	0	1640	0		83	0	0
78										192	0	1640	0		83	0	0
79										192	0	1640	0		83	0	0
80										192	0	1640	0		83	0	0
81										192	0	1640	0		83	0	0
82										192	0	1640	0		83	0	0
83										192	0	1640	0		83	0	0
84										192	0	1640	0		83	0	0
85										192	0	1640	0		83	0	0
86										192	0	1640	0		83	0	0
87										192	0	1640	0		83	0	0
88										192	0	1640	0		83	0	0
89										192	0	1640	0		83	0	0
90										192	0	1640	0		83	0	0
91										192	0	1640	0		83	0	0
92										192	0	1640	0		83	0	0
93										192	0	1640	0		83	0	0
94										192	0	1640	0		83	0	0
95										192	0	1640	0		83	0	0
96										192	0	1640	0		83	0	0
97										192	0	1640	0		83	0	0
98										192	0	1640	0		83	0	0
99										192	0	1640	0		83	0	0
100										192	0	1640	0		83	0	0
101										192	0	1640	0		83	0	0
102										192	0	1640	0		83	0	0
103										192	0	1640	0		83	0	0
53	Shtet	Tushemisht	3664	255	Pa frutë	7600		3	239					144	83	0	0
54	Gjergji Koli Poce	Tushemisht	3664	48/3	Arë	1500		4	189	1500	192	288000					288000
	Ameti Beni Shuke																
	Linda Berti Loni																
	Erlon Sotiraj Poce																
	Nikolin Sotiraj Poce																
	Gjola Sotiraj Vako																
	Kristina Kops Sparollari																
	Vaslika Kops Mrika																
	Dhimitra Kops Plimshi																
	Diana Sandri Gace																
	Vjollca Sandri Angjo																
	Leonora Mitr Angjellari																
	Eralda Nesti Angjellari																
	Armand Nesti Angjellari																
	Ieda Nesti Angjellari																
55	Shtet	Tushemisht	3664	48/2	Arë	525		4	188	525	192						0
56	Shtet	Tushemisht	3664	46/12	Trull	12800		4	224			5516	1640				0
57	Shtet	Tushemisht	3664	46/10	Pa frutë	58555		4	216					4500	83		0
58	Dhimitri Mihal Bardhi	Tushemisht	3664	44/1	Arë	1430		2	219	440	192	84480					84480
59	Shtet	Tushemisht	3664	49/2	Arë	1000		4	59	830	192						0
60	Gjergji Kops Plimshi	Tushemisht	3664	49/3	Ledh	2300		4	60					1014	83	84162	84162
	Miriana Kops Leka																
	Dritan Ali Tasellari																
	Leonard Piro Tasellari																
	Ferdinand Piro Tasellari																
	Diana Piro Tasellari																
	Ibir Piro Tasellari																
61	Gjergji Kops Plimshi	Tushemisht	3664	49/1	Ledh	2700		4	58					2700	83	224100	224100
	Miriana Kops Leka																
	Drita Ali Tasellari																
	Leonard Piro Tasellari																
	Ferdinand Piro Tasellari																
	Diana Piro Tasellari																

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2023

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 192 lekë